

Dr. Vehbetu Zuhejli

Shfuqizimi

XIV

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Shfuqizimi

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Hyrje në shfuqizim

a. Ndonjëherë përdoret me termin *tema e shfuqizimit* – te shumica absolute e ekspertëve të usulit – dhe ka për qëllim *sqarim shtesë* rreth temave të Kur'anit dhe sunetit, prej urdhëresave, ndalesave, etj., dhe çka ka prej lidhjes së sinqertë me ligjet e prodhuara prej tyre, dhe me të ka për qëllim që i ngarkuari ta zbatoj atë.

Quhet **“shfuqizim”**, apo *sqarim i ndryshimit*, e kjo në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

وَإِذَا بَدَّلْنَا آيَةً مَّكَانَ آيَةٍ

“Kur një ajet e zëvendësojmë me një ajet tjetër.” (En-Nahl : 101)

Nga aspekti gjuhësor, njëra prej kuptimeve të shfuqizimit është **“ndryshimi”**, dhe me të nënkuptojmë: **Të hiqet diçka dhe atë ta zëvendësoj diçka tjetër.**

Tema e shfuqizimit renditet pas temave të burimeve të sheriatit, për shkak të mundësisë së paraqitjes në ato burime. Renditet para temës së ixhtihadit sepse prej kushteve më të rëndësishme të muxhtehidit – *siç do ta sqarojmë* – është njohja e ligjit shfuqizues dhe ligjit të shfuqizuar, dhe për shkak se shfuqizimi është prej rrugëve të bashkimit dhe përputhshmërisë së dy teksteve kundërthënëse nëse mësohet kronologjia e tyre, ashtu që ligji i mëvonshëm e shfuqizon ligjin e mëhershëm, dhe kjo e ndriçon rrugën para muxhtehidit për të përpiluar ligjin nëpërmjet argumentit sheriatik.

b. Tema e shfuqizimit në thelb është çështje kronologjike, përpos asaj që ndërlidhet me muxhtehidin, si njohuri e domosdoshme me ligjet e shfuqizuara, sepse ndërlidhet me kohën e pejgamberit s.a.v.s dhe kohën e zbritjes së shpalljes, sepse nuk ka shfuqizim përpos me shpallje prej Zotit.

Ekspertët e usulit kanë theksuar se i ngarkuari duhet që të dijë:

- shfuqizimin,
- shfuqizuesin, ku shfuqizues është Allahu i Lartmadhëruar, dhe
- argumentin e shfuqizuesit.

c. I pari i cili e ka zgjidhur çështjen e shfuqizimit është Shafiiju r.a. në librin e usulit **“Er-Risale”**. Ai e llogaritë si *çështje e sqarimit të ligjeve* dhe jo i llojit të anulimit të teksteve.

d. Sujutiu në librin **“El-Itkan”** mendon se në njëzet ajete të Kur’anit fisnik ka ndodhur shfuqizimi, siç janë:

- ajetet e testamentit të prindërve dhe të afërmve për mirësi,
- ajeti i testamentit të bashkëshorteve pas vdekjes së bashkëshortit për të qëndruar një vit të plotë në shtëpinë e burrit të saj,
- ajeti i mbajtjes (izolimit) së prostitutave në shtëpi,
- ajeti i ndalimit të luftimit në muajt e shenjtë,
- ajeti i qëndrueshmërisë së muslimanit përballë dhjetë armiqve,
- ajeti i dhënies së sadakasë para bashkëbisedimit me pejgamberin s.a.v.s.

e. Shfuqizimi shkon me fleksibilitetin e parimit të gradualitetit në ligjësim me të cilën veçohet islami gjatë kohës së shpalljes, e ajo është realizimi i interesave të njerëzve, i cili edhe është objektiv i ligjësimit.

f. Ndonjëherë ligji i shfuqizuar është i barabartë me ligjin e shfuqizuar, ose të një niveli më të dobët ose të një niveli më të fuqishëm.

g. Sheriati islam është shfuqizues i të gjitha ligjeve qiellore të mëhershme përpos bazave dhe parimeve të përgjithshme, si në ligjet degëzore, të cilat nuk i cenojnë bazat e besimit dhe të moralit.

Shfuqizimi veçse ka ndodhur në sheriatin tonë, si në Kur’an edhe në sunet, varësisht prej interesit dhe zhvillimit kohorë, ndërsa nuk ka ndodhur në argumentet tjera siç janë ixhmai dhe kijasi, përpos në ixhmaë i cili mbështetet në esencën e interesit.

Punimi i studimit të shfuqizimit do të jetë si në vijim:

- **Definicioni i shfuqizimit,**
- **Shtyllat e shfuqizimit,**
- **Urtësia e shfuqizimit,**
- **Dallimi në mes të shfuqizimit dhe përcaktimit,**
- **Specifikimi i shfuqizimit,**
- **Mendimet e dijetarëve për shfuqizimin,**
- **Sfera e shfuqizimit dhe kushtet e tij,**
- **Llojet e shfuqizimit në argumentet e shariatit,**
- **Format e shfuqizimit,**
- **Rrugët e të kuptuarit të shfuqizimit,**
- **Koha dhe kronologjia e shfuqizimit.**

Tema e parë

- Definicioni.
- Shtyllat.
- Urtësia.
- Dallimi në mes të shfuqizimit, përcaktimit dhe specifikimit.

Kuptimi gjuhësor: gjuhësisht “shfuqizimi” ka dy kuptime:

E para: Zhvlerësimin dhe largimin.

Thuhet: Dielli e zhvlerësoi hijen. Era i humbi gjurmët e këmbëve, që do të thotë, i ka larguar. Ngjashëm është edhe thënia, pleqëria e largoi rininë, kur e humbë rininë, po ashtu, humbja e shekujve dhe kohëve.

E dyta: Bartje dhe ndryshim nga një gjendje në një gjendje tjetër me të mbeturit e esencës së çështjes në vetvete. Thuhet, e kam shkruar librin, që do të thotë se, i kam bartur idetë në libër. Ngjashëm me këtë kuptim e kemi thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّا كُنَّا نَسْتَنْسِخُ مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“Ne kemi kërkuar të shkruhet se ç’vepronit.” (El-Xhathije : 29)

Po ashtu, shpërndarja e trashëgimisë, që do të thotë, bartja e pasurisë prej trashëgimtarit te i trashëguari.¹

Kuptimi terminologjik

Në terminologjinë e ekspertëve të usulit, shfuqizimi ka dy definicione të njohura:²

E para: **Sqarimi i mëvonshëm i skadimit të afatit të ligjit nëpërmjet rrugës ligjore.**

Pjesa “**skadimi i afatit**” – ligji i shfuqizuar ka qenë i kufizuar tek Allahu me qëllim që të përfundoj në atë afat. Kështu e ka definuar Raziju dhe Bejdaviju.

E dyta: **Heqja e ligjit sheriatik me argument sheriatik të mëvonshëm.** Ky definicion është i Ibni Haxhibit dhe është i afërt me definicionin e Ebi Hashim el Muëtezil: Hiqet një ligj i ligjësuar në rrugë ligjore në formë specifike.

Kadiju Bakilaniju e definon kështu: **Heqja e ligjit sheriatik në mënyrë ligjore në kohë të mëvonshme.** Që do të thotë se, shfuqizuesi është heqës i vazhdimësisë së veprimit me ligjin e mëhershëm. Këtë definicion e ka përkrahë Ibn Sebkiu në librin “**Xhemul-Xhevamiu**” që përfshinë shfuqizimin para të shfuqizuarës.

Gazaliu e definon kështu: **Ligjërimi i cili tregon heqjen e ligjit të aprovuar me ligjërimin e mëhershëm në formën e vet për ta pasuar atë çka ka qenë me ligj të mëvonshëm.**

Sadru Sheriati ibn Mes’udë e definon kështu: **Sjellja e argumentit të mëvonshëm të sheriatit, nga argumentimi sheriatik i cili aprovon të kundërtën e atij ligji.** Që do të thotë se ligjin e argumentimit sheriatik të mëvonshëm prej atij të mëhershëm.

Shevkaniju e ka zgjedhur një definicion tjetër: **Shfuqizimi është heqja e ligjit sheriativ me ligj të njëjtë, më të vonshëm se ai.** Këtë e ka zgjedhur për të përjashtuar nga definicioni atë çka është pasqyruar te definicioni i Gazaliut dhe të tjerëve, e kjo për t’u shmangur nga kritikata, edhe pse ai u përgjigjet me përgjigje bindëse.

Nga këto definicione të ndryshme por me kuptim të përafërt vërtetohet se prej tyre prioritet ka definicioni i dytë për arsyet si në vijim:

1. **Shfuqizimi bëhet nga fjalimi i Ligjvënësit, e ai është Allahu i Lartmadhëruar.** Shfuqizimi nuk bëhet nga fjalimi i dikujt tjetër. Përderisa ajo çka ndodh me veprimin e pejgamberit s.a.v.s., veprim i cili tregon shfuqizim është argument i mirënjohur i cili tregon shfuqizim, është argument i mirënjohur i cili është bërë i ditur prej fjalës së Allahut i cili

tregon për heqjen e atij ligji dhe shfuqizimi nuk buron nga fjala e të dërguarit të Allahut s.a.v.s. sepse pejgamberi s.a.v.s. nuk ka autorizim të heq ndonjë ligj sheriatik prej mendjes së tij.

Kur një ligji sheriatik i skadon afati kohorë i cili ka qenë i paraparë ose që hiqet shkaku prej tij, ligjërisht nuk quhet shfuqizim. Kur një ligji sheriatik i skadon afati nëpërmjet rrugës natyrale, si f.v., prej vdekjes, apo harresës, apo paaftësisë si f.v., për shkak të shkurtimit (humbjes) të këmbëve, bie edhe obligueshmëria e larjes së këmbëve gjatë abdesit, e ky nuk quhet shfuqizim.

2. E shfuqizuara – Është ligjërimi i mëhershëm. Ligji sheriatik përmban urdhëresën, ndalesën edhe lajmin, të cilat janë pjesë bashkëngjitëse të ligjit dhe që e aprovojnë atë nëpërmjet tekstit ose të kuptuarit prej tekstit apo prej të kundërtës së saj. Për këtë arsye pafuqizimi i asaj çka ligjësohet me gjykim të mendjes është shfajësia, ose lejimi bazik para se të vjen ligji,³ ose që është ligjësuar prej traditave të injorancës ose të ligjeve tjera, ose vendosja e ligjeve të reja, e kjo nuk quhet shfuqizim. Në kohën e injorancës nuk ka pasur obligueshmëri të adhurimeve, ose të ndalesa e çështjeve të cilat nuk kanë qenë të ndaluara në kohën e injorancës, si f.v., ndalimi i alkoolit dhe tradita e adoptimit të fëmijëve, martesë me gruan e babës pas shkurorëzimit prej tij. Kjo nuk konsiderohet shfuqizim sepse ajo çka ka qenë në kohën e injorancës nuk llogaritet shfuqizim.

3. Patjetër duhet të kalojë një afat kohorë në mes të ligjit shfuqizues prej ligjit të shfuqizuar. Ky është qëllimi me vonimin e ligjit shfuqizues, apo mëvonësinë e saj, për të qenë pengesë për mos lejim të kundërthënies apo korruptimit në ligjet e Ligjvënësit, sepse përcaktimi me të njëjtin ligjërimit me të papërcaktuarën është sikurse përjashtimi dhe përcaktimi me kusht, dhe me qëllim nuk quhet shfuqizim sepse ligjërimit në të njëjtën kohë me të parën (të shfuqizuarën) nuk konsiderohet heqje, apo shlyerje e ligjit të ligjërimit të parë, por është sqarim dhe kompletim i kuptimit pas aprovimit të tij, ose përcaktim për një kohë, ose kushtëzim, ose ngjashëm me të. Shfuqizimi është heqja e diçkaje pas aprovimit të tij.

Vërehet se shprehja *me mëvonësinë* është i mjaftueshëm i shprehjes “po mos të ishte ajo do të ishte aprovim i pandërprerë” dhe sipas definicionit bashkimi i këtyre dy termave do të ishte: përsëritje.

Pjesët përbërëse të shfuqizimit

Nga definicioni kuptohet qartë se pjesët përbërëse të shfuqizimit janë katër:⁴

- **Mjetet e shfuqizimit.**
- **Shfuqizuesi.**
- **E shfuqizuara, dhe**
- **E shfuqizuar për...**

Mjetet e shfuqizimit: Është *ffala* e cila tregon për heqjen e ligjit të aprovuar.

Shfuqizues është Allahu i Lartmadhëruar sepse ai ka të drejtë absolute të heqë ligjin sipas dëshirës së Tij.

E shfuqizuar është ligji i hequr (shlyer).

E shfuqizuar për... është adhuruesi apo i ngarkuari me ligje të sheriatit.

Prej shembujve të së “**shfuqizuarës**”: Shfuqizimi i dhënies së sadakasë para takimit me pejgamberin s.a.v.s. dhe ligji për testamentin për prindërit dhe farefisën dhe ligji për të qëndruar një vit të plotë gruaja në shtëpinë e burrit të saj kur të vdes burri.

Thuhet: Ajeti i luftës në suretu tevbe i ka shfuqizuar 113 çështje në Kur'an i cili ajet është:⁵

فَإِذَا انْسَلَخَ الْأَشْهُرُ الْحُرُمُ فَاقْتُلُوا الْمُشْرِكِينَ حَيْثُ وَجَدْتُمُوهُمْ وَخُذُوهُمْ
وَاحْصُرُوهُمْ وَاقْعُدُوا لَهُمْ كُلَّ مَرْصِدٍ ۚ

“E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t’i gjeni, robëroni dhe ngujoni ata, e vendojuni pritë në çdo shteg.” (Et-Tevbe : 5)

Shfuqizues i vërtetë është Allahu i Lartmadhëruar, mirëpo në mënyrë metaforike përdoret për ligjin sheriatik ose që krijohet bindje e shfuqizimit të ligjit me atë shfuqizues ligji ose në vet tekstin shfuqizues.

Shembulli i të parës, thuhet: Obligueshmëria e agjërimit të muajit ramazan e ka shfuqizuar obligueshmërinë e ditës së *ashures*, e ky është shfuqizimi metaforik.

Shembull i së dytës, thuhet: Filani e shfuqizon Kur'anin me sunet, që do të thotë se, mendon ashtu, se ai është shfuqizues.

Shembull i së tretës: Ajeti i luftës së përmendur i ka shfuqizuar ajetet e paqes dhe thirrjes me urretësi dhe me këshilla të mira, e ai është shfuqizuesi.

Urtësia e shfuqizimit

Ligjet aprovohen për të pasur parasysh interesin e përgjithshëm të njerëzve dhe Ligjvënësi duhet të ketë urtësi të madhe për ekzistencën e krijesave. Ai i sprovon ata që të zbatojnë kërkesat e Ligjvënësit.

Në pedagogji, për t'u edukuar personi, duhet që domodoshmërisht të dihen rrethanat e tij, kushtet e përgatitjes së tij, zhvillimin e tij, aftësinë e tij, ashtu që të sillet me të në bazë të përgatitjes së tij dhe çka është e përshtatshme me të, sepse umeti është sikurse fëmija, ushqehet me ushqim i cili i përshtatet moshës dhe në bazë të zhvillimit të tij.

Duke pasur parasysh interesat e përgjithshme dhe të veçanta, ka ardhur deri te shfuqizimi i ligjeve dhe vet shariatit islam sepse sheriatit është ligj i të ngarkuarve. Patjetër duhet të bëhet ndarja në mes të ligjit dhe të ligjësuarve sepse për të ligjësuarit, në një epokë, një orientim i caktuar është në dobi të tyre, pastaj ndryshon interesi për ta për shkak të zhvillimit sepse interesi ndryshon varësisht prej ndryshimit të kohëve, sikurse përdorimi gradual i barërave. Ligji për fe është sikurse barërat për trupin. Është në interes për njerëzit e ngarkuar, që të largohet ligji i mëhershëm dhe të shikohet ligj tjetër. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِّنْهَا أَوْ مِثْلَهَا ۗ أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?” (El-Bekare : 106)

Dobia është në anën e të ngarkuarve sepse ata janë objekt i cili duhet të edukohet që të realizohet dobia për ta prej aprovimit (zbritjes) të ligjit.

Përpos kësaj, dihet se sheriatit islam është vula e ligjeve të mëparshme, dhe se është e përhershme dhe e pafund, pejgamberi s.a.v.s. është vula e pejgamberëve i cili ka ardhur pas një varg pejgamberësh. Ishte ndërprerë shpallja prej Zotit për një periudhë të caktuar, saqë u ngrit çështja deri në atë

nivel që besimi i vërtetë u largua nga mendjet e njerëzve dhe filluan të adhurojnë idhujt, saqë nuk ishte e lehtë që zakonet dhe traditat e tyre të largohen, përpos në mënyrë graduale.

Këto rrethana kanë ndikuar që të shikohet me urtësi gjendja e arabëve për t'i bartur arabët në një gjendje më të mirë në mënyrë graduale, kështu, shfuqizimi apo kalimi i një ligji prej një pozite në një pozitë tjetër të ngjashme, apo ndryshimi i njëjtë, ose në pozitë më të mirë, ose më të dobët, pra të gjitha format e gradualitetit për përmirësimin e gjendjes së tyre është bërë që të u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tyre, që ata lehtësisht të pranojnë shpalljen qiellore, në organizimin e çështjeve të jetës.

Konkludojmë në atë se shfuqizimi i ka dy rregulla:

E para: Sigurimi i interesave të të ngarkuarve për shkak se janë të fisnikëruar prej Allahut të Lartmadhëruar e jo pse e ka detyrim, që do të thotë se urtësia më e rëndësishme e shfuqizimit është realizimi i interesave të njerëzve e cila është qëllimi bazik i ligjësisht të ligjeve. Ato interesa ndryshojnë varësisht prej kohës dhe rrethanave.

E dyta: Sprovimi i të ngarkuarve me zbatim të urdhëresave dhe ndalesave prej tyre dhe përsëritjen e sprovës posaçërisht në urdhërimin e tyre në atë çështje e cila ka qenë e ndaluar për ta dhe ndalesën e tyre në atë e cila ka qenë urdhëresë për ta. Dëgjueshmëria në rastin e ndryshimit të urdhrit është më bindëse në tregueshmërinë e besimit dhe të veprimit.⁶

Shembuj të ligjësimit, ku shihet fleksibiliteti i urtësisë së zbatimit të shfuqizimit

Do t'i përmend disa shembuj të shfuqizimit të cilat rezultojnë interesin dhe gradualitetin:⁷

1. Ligjësimi ka heshtur për një kohë të caktuar për llojin e martesës së përkohshme e cila ka ekzistuar në kohën e injorancës, pastaj është shfuqizuar me sistemin e martesës në të cilin sistem gruaja i ka të drejtat e plota siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi.” (El-Bekare : 228)

2. Në fillim pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar të vizitohen varrezat, nga frika se kjo do të shpinte në idhujtari, tek ata të cilët e kishin besimin e dobët, pastaj e ka lejuar vizitën me thënien e tij: **“Ju kam pas ndaluar vizitën e varreve, tani vizitoni, sepse vizita ju bën të jeni të devotshëm në këtë botë dhe ju bën të kujtoni botën tjetër.”**⁸

3. Në fillim, Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar testamentin për prindërit dhe familjarët, si kundërpërgjigje ndaj sistemit të injorancës, ku femrës i ndalohej e drejta e trashëgimisë dhe fëmijët më të mëdhenj kishin ndikim në pasurinë e mbetur dhe pronari i lë testament cilit dëshiron. Pastaj kanë zbritur ajetet e trashëgimisë në shpërndarjen e drejtë në mes të meshkujve dhe femrave, pa marrë parasysh afërsisë nga ana e babës apo ndonjëherë nga afërsia e nënës.

4. Alkooli është ndaluar duke kaluar në disa faza, duke filluar në paraqitjen e alkoolit si diçka jo e mirë:

ثَمَرَاتِ النَّخِيلِ وَالْأَعْنَابِ تَتَّخِذُونَ مِنْهُ سَكَرًا وَرِزْقًا حَسَنًا ۚ

“Nxirrni prej tyre pije (lëngje) dhe ushqim të mirë...” (En-Nahl : 67)

Pastaj e ka sqaruar dëmin dhe dobinë si formë tregtie:

قُلْ فِيهِمَا إِتْمَ كَبِيرٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَإِِنَّهُمَا أَكْبَرُ مِن نَّفْعِهِمَا

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: “Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre. Të pyesin ty edhe se ç’do të japin. Thuaj: Tepërcën! Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq).” (El-Bekare : 219)

Pastaj e ka ndaluar ditën, për shkak të faljes së namazit:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْرُبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَارَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ

“O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç’flitni, (En-Nisa : 43)

Pastaj ndalesën e prerë me ajetin:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.” (El-Maide : 90)⁹

5. Po ashtu, edhe kamatën e ka ndaluar faza-faza. Në fillim e ka bërë krahasimin me zekatin i cili ka shpërblime të shumëfishta, përderisa kamata nuk ka zhvillim, as fryte dhe as begati:

وَمَا آتَيْتُم مِّن رَّبًّا لِّيَرْبُو فِي أَمْوَالِ النَّاسِ فَلَا يَرْبُو عِنْدَ اللَّهِ ۖ وَمَا آتَيْتُم مِّن زَكَاةٍ تُرِيدُونَ وَجْهَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُضْعِفُونَ

“Dhe çka të jepni nga pasuria për të shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet te All-llahu, e çka të jepni

nga sadakaja (bamirësia) me qëllim që t'i afroheni All-llahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi).” (Err-Rrumë : 39)

Pastaj e ka kategorizuar si padrejtësi dhe ua ka ndaluar jehudëve:

فَبِظُلْمٍ مِّنَ الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا عَلَيْهِمْ طَيِّبَاتٍ أُحِلَّتْ لَهُمْ وَبِصَدِّهِمْ عَنِ
سَبِيلِ اللَّهِ كَثِيرًا

“Dhe për shkak të mizorisë së tyre, që ishin jahudi, dhe për shkak se penguan shumë nga rruga e All-llahut, Ne ua ndaluam (ua bëmë haram) disa (lloje ushqimesh) të mira që u ishin të lejuara.” (En-Nisa : 160)

Pastaj në cilësimin si vepër e zyrtë dhe e keqe e cila ka ekzistuar në kohën e injorancës, ku e hanin pasurinë e njëri-tjetrit shumëfish:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا الرِّبَا أَضْعَافًا مُّضَاعَفَةً ۖ

“O ju të cilët besuat, mos e hani kamatën që po e shumëfishoni” (Ali Imran : 130)

Pastaj me ndalim të përgjithshëm me ajetet:

وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۚ

“...e All-llahu ka lejuar shitblerjen, ndërsa ka ndaluar kamatën.” (El-Bekare : 275)

يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُزِيهِ الصَّدَقَاتِ ۚ

“All-llahu zhduk kamatën dhe shton lëmoshën.” (El-Bekare : 276)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ
﴿٢٧٨﴾ فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ ۖ وَإِن تُبْتُمْ فَلَكُمْ
رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ

“O ju që besuat, keni frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtarë të sinqertë hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se

nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me All-llahun dhe të dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj - askënd nuk e dëmtoni, e as vetë nuk dëmtoheni.” (El-Bekare : 278, 279)

6. Në fillim është ligjësuar që namazi të falet nga dy rekate në mesditë dhe nga dy rekate në mesnatë, si lehtësim ndaj njerëzve derisa e kanë kuptuar konceptin e namazit, ta shijojnë ëmbëlsinë e saj dhe shijen e lutjeve të saj.

7. I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka ndaluar që të konservohet mishi i kurbaneve, për shkak të arritjes së disa delegacioneve në Medine, pastaj e ka lejuar me thënien: “Ju kam ndaluar mishin e kurbaneve për tri ditë, për me u dhënë mundësi atyre të cilët nuk kanë pasur mundësi të vinë me kohë, ndërsa tani e tutje hani çka keni për të ngrënë dhe ushqeni tjerët dhe rezervoni.”¹⁰

8. Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar që pijet e lejuara të pihen nga gotat e alkoolit, pastaj ka lejuar që të përdoren të gjitha enët, kur ka thënë: “U kam ndaluar nga pijet përpos në mungesë të tyre, tani pini nga çdo gotë, vetëm alkool mos pini.”¹¹

Dallimi në mes të shfuqizimit dhe intuitës

Është ngatërruar çështja e shfuqizimit me intuitën. Duke u bazuar në intuitën, jehudët e mohojnë që nga baza, gjë që te ata ka rezultuar të mohojnë zhvillimin e ligjeve dhe ndryshimin e tyre.

Edhe te shiitët është ngatërruar çështja e shfuqizimit edhe pse deklarojnë se mund të ndodhë, mirëpo ato nuk bëjnë dallimin në mes të shfuqizimit dhe intuitës. Janë argumentuar me thënien e Aliut r.a.: ***“Po mos të ishte intuita do t’u tregoja se çka është ekzistent deri në ditën e kijametit.”*** Xhafer bin Sadiku r.a. ka thënë: ***“Çka zbulon Allahu për një çështje është sikurse e ka zbuluar çështjen e Ismailit.”*** që do të thotë çështjen për sakrifikimin e tij.

Ata mendojnë se ky është koncepti i thënies së Zotit të Lartmadhëruar: ***“Allahu çka dëshiron fshinë dhe çka dëshiron vendosë.” (Err-Rread : 39)*** dhe i përshkruajnë cilësinë e harresës për Zotin e Lartmadhëruar dhe kjo shpie në pabesim. Mirëpo unë kursehem nga kjo edhe pse ata kanë ngatërruar çështjen e shfuqizimit dhe intuitës. Ashtu siç tregojnë librat e usulit, siç është edhe libri ***“Irshadul Fuhulë”***. Për këtë arsye e shoh të domosdoshme sqarimin në mes të këtyre dy çështjeve.¹²

Fjala ***“BEDA”*** gjuhësisht është një shprehje për zbulimin e një çështjeje pas fshehjes së saj. Na u zbulua (sqarua) çështja e filanit, që do të thotë *na u paraqit*. Na u paraqitën simbolet e qytetit, që do të thotë se janë paraqitur pasi që nuk janë parë më herët. Në lidhje me këtë është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَوْ أَنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَمِثْلَهُ مَعَهُ لَافْتَدَوْا بِهِ مِنْ سُوءِ الْعَذَابِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۖ وَبَدَا لَهُمْ مِنَ اللَّهِ مَا لَمْ يَكُونُوا يَحْتَسِبُونَ

“E sikur të ishte e atyre që nuk besuan, e tërë ajo çka ka në tokë e edhe njëherë aq, do ta jepnin kompensim për t’i shpëtuar dënimit të tmerrshëm në ditën e kijametit. E prej All-llahut do t’u paraqitet (lloji i dënimit) çka as nuk kanë mund të mendojnë.” (Ez-Zumer : 47)

pastaj ajeti:

بَلْ بَدَا لَهُمْ مَا كَانُوا يُخْفُونَ مِنْ قَبْلُ ۖ وَلَوْ رُدُّوا لَعَادُوا لِمَا نُهُوا عَنْهُ وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ

“Jo, (s’është ashtu) po atyre iu paraqit ajo që e mbanin fshehtë më parë, prandaj edhe sikur të ktheheshin ata do të përsëritnin atë që e kishin të ndaluar, e s’ka dyshim, ata janë gënjeshtarë.” (El-Enam : 28) pastaj ajeti:

وَبَدَا لَهُمْ سَيِّئَاتُ مَا عَمِلُوا وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ

“Dhe u dalin në shesh të këqijat që i kanë punuar, dhe i përfshinë ajo me të cilën talleshin.” (El-Xhathije : 33)

Shfuqizimi i ligjit të mëhershëm prej Zotit të Lartmadhëruar nuk e ka kuptimin e zbulimit pas fshehjes sepse do të cilësohej Zoti i Lartmadhëruar që të mësoj dituri pasi që nuk ka ditur. Kjo është absurde sa i përket madhërisë së Allahut sepse nuk mund t’i fshihet Atij asgjë, as në tokë e as në qiell. Dituria e Tij përfshinë çka ka qenë dhe çka do të jetë, siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Ai është i Ditur për çdo send.” (El-Bekare : 29).

Pastaj thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

عَالِمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ

“Ai di të padukshmen dhe të dukshmen.” (El-Enam : 73)

Ajeti tjetër:

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ ۚ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ ۚ وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظُلُمَاتِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

“Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie

dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (LehviMahfudh).” (El-Enam : 59)

Ajeti tjetër:

مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِّن قَبْلِ أَن نَّبْرَأَهَا ۚ إِنَّ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ

“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (libër - Lehvi Mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për Allahun është e lehtë.”

Te rasti i shfuqizimit, Allahu i Lartmadhëruar që nga e para pa fillim, çka ka urdhëruar që robërit të veprojnë, do të realizohet interesi në një kohë prej kohëve dhe shfuqizimi do të rezulton interes në një kohë tjetër, sikurse Zoti i Lartmadhëruar e di se çka ndalon, në veprimin e asaj ndalese ka dëm në një kohë të caktuar dhe mbetet dëmtuese në një kohë tjetër, ndërsa shfuqizimi i asaj ndalese sjell interes (dobi). Mirëpo kjo nuk nënkupton që kjo është zbuluar pasi që ka qenë e fshehur, dhe nuk ka urdhëruar çka është e dëmshme dhe as nuk ka ndaluar atë çka është e dobishme. Shembull: Lejimi i ushqimit gjatë natës së ramazanit dhe ndalimi i tij gjatë ditës së ramazanit. Kështu pra, shfuqizimi bëhet, jo për shkak të zbulimit të një sendi i cili ka qenë i fshehur për Allahun e Lartmadhëruar nga çështja e shfuqizuar, por ka qenë për shkak të urdhrit për të realizuar dobi (interes) gjatë një periode të caktuar dhe të mos ekzistimit të atij interesi pas asaj kohe.

Këtë koncept e tregon Zoti i Lartmadhëruar:

يَسْأَلُهُ مَن فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ

“(Ai mbetet) Atij i drejtohen me lutje kush është në qiej e në tokë dhe Ai në çdo moment është i angazhuar në çështje të reja (falë mëkate, largon brengosje, jep jetë, jep vdekje, krijon gjendje, zhduk të tjera etj.).” (Err-Rrahman : 29)

që do të thotë se në çdo kohë ndodhin çështje dhe ndryshojnë gjendjet, siç tregon Zamahsheri në librin “Keshaf” dhe siç thotë Husejn bin Fadli për

kuptimin e ajetit: “Janë çështje statike dhe nuk janë çështje zbuluese.” që do të thotë se, janë paraparë për njeriun varësisht çka është në dobi kur të vjen koha dhe nuk i zbulon pas përcaktimit, që do të thotë se janë të përcaktuara në diturinë e Tij të pakufishme të pafillim.

Përderisa qëllimi i ajetit: “**Allahu fshinë çka dëshiron.**”, fjala *fshinë* ka kuptimin e shfuqizimit dhe ligjësimin e shfuqizuesit, siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: “**Pa dyshim se të mirat i largojnë të këqijat.**”

Përfundim: Urdhri i Allahut është absolut. Atë që Allahu e ka ditur se do të jetë konstante, nuk i nënshtrohet shfuqizimit. Çka e ka ditur se dobia do të jetë për një kohë, e ka ditur përfundimin që më herët se do të ndodhë shfuqizimi kur do të ndodh (shfuqizimi) dhe jo se e ka kuptuar përfundimin në atë kohë apo në atë moment, ashtu që diturisë së Tij t’i bashkëngjitet padituria.

Dallimi në mes të shfuqizimit dhe specifikimit

Specifikimi dhe shfuqizimi kanë pikë të përbashkët nga një këndvështrim sepse secila prej tyre e përkufizon ligjin nga gjithëpërfshirja e tij ose secili prej tyre e specifikon ligjin nga një pjesë të cilën e përfshinë fjala, vetëm se specifikimi e përkufizon ligjin nga disa pjesë të saj, përderisa shfuqizimi përkufizon ligjin nga disa kohë.

Kështu ato dallohen nga një këndvështrim tjetër.

Specifikimi është sqarim i asaj çka ndahet nga përgjithësia, të cilën ligjëruesi nuk e ka pasur për qëllim atë pjesë kur e ka përdorur atë fjalë, që do të thotë se ligji ka të bëjë me disa pjesë të së përgjithshmes që nga fillimi dhe nuk i përfshinë të gjitha.

Shfuqizimi: Ligjëruesi e ka hequr një pjesë (apo tërësinë) nga fjala për të cilin qëllim e ka përdorur atë fjalë, që do të thotë se në fillim ligji i ka përfshirë që të gjitha pjesët, pastaj e heqë atë ligj me shfuqizim.

Nëse Ligjvënësi thotë: Gjithmonë veproje këtë vepër, mirëpo vazhdimësia e saj është e kushtëzuar që të mos ketë shfuqizim.

Me fjalë tjera, **specifikimi** është sqarim se specifikuesi që nga fillimi nuk e ka pasur atë qëllim.

Përderisa, **shfuqizimi** është ndalimi pas fuqizimit.¹³

Nga ky dallim i përgjithshëm rezultojnë nëntë dallime tjera sekondare, të cilat Gazaliu i ka përmbledhur në pesë, e ato janë:¹⁴

1. Specifikimi bëhet së bashku me fjalën, por mund të jetë i mëvonshëm, ndërsa shfuqizimi duhet të jetë vetëm i mëvonshëm.

2. Specifikimi nuk bëhet vetëm për një çështje. Shembull: Jepi sadaka Zejdut, e që të shfuqizimi është e kundërta sepse lejohet të bëhet vetëm për një çështje.

3. Specifikimi lejohet edhe prej çështjeve transmetuese edhe logjike, ndërsa shfuqizimi vetëm prej transmetimit.

4. Te specifikimi, mbetet tregueshmëria e fjalës së përgjithshme, me kuptimin e saj të përgjithshëm pas specifikimit. Përderisa, shfuqizimi zhvlerëson tregueshmërinë e të shfuqizuarës për diçka prej ligjit për të ardhmen në tërësi dhe e bën që e shfuqizuara të mos jetë në gjendje të argumentoj.

5. Lejohet specifikimi me kijasë, me lajmin (hadithin) e vetmuar dhe argumentet tjera si f.v., me traditë, ndërsa nuk lejohet shfuqizimi me kijasë (analogji) dhe nuk lejohet shfuqizimi i argumentit të prerë përpos me argument të prerë siç është vet. Nuk shfuqizohet hadithi MUTEVATIR (me shumë transmetime) me lajmin (transmetimin) e vetmuar sepse e prera nuk largohet me të dyshimtën. Ky është mendimi i Shafiijeve të cilët deklarojnë se nuk lejohet shfuqizimi i Kur'anit me sunet. Shumica absolute nuk e pranojnë një mendim të tillë.

Hanefijtë e shtojnë edhe një dallim, shfuqizimi nuk ndodhë në ngjarje (lajme) përderisa specifikimi ndodhë¹⁵.

Ibn Hazmi bën dallimin në mes të shfuqizimit, specifikimit dhe përjashtimit dhe thotë:¹⁶

–**Shfuqizim** është heqja e ligjit, i cili e ka merituar të hiqet, ndërsa,

–**specifikimi** është të specifikohet një individ nga individët e tjerë, nga lloji i individëve, ashtu siç është specifikuar Muhamedi a.s. për faljen e namazit të natës si namaz farz dhe të lejuarit me nëntë gra. Përderisa

–**përjashtimi** është ajo çka buron nga fjala e përgjithshme, pastaj përjashtohet diçka nga ajo fjalë, si f.v., “**vetëm për bashkëshortet e tyre.**” (**El-Muëminunë**) e të ngjashme, ndërsa sa i përket specifikimit, nëse shikohet me seriozitet është përjashtimi i drejtë.

Dallimi në mes të shfuqizimit dhe të përjashtimit është se me fjalën përjashtuese të disa pjesëve, nuk ka qenë qëllimi i detyrimit të atyre pjesëve

me fjalën përgjithësuese sepse nuk është pikësnyuar prej fillimit asgjë tjetër pos përjashtimit, përderisa sa i përket shfuqizimit: Ajo për çka jemi urdhëruar të largohemi, sot qëllimi i asaj ndalese ka qenë nga dje, e cila është krejt ndryshe te përjashtimi.

Vërehet se ky është dallimi i përgjithshëm i cili dallim është treguar në mes të shfuqizimit dhe specifikimit.

Pastaj Ibn Hazmi thotë: “Shfuqizimi është lloj prej llojeve të përjashtimit sepse është përjashtimi i kohës dhe specifikimi i veprës, përpos kohëve tjera. Kështu që do të ishte e drejtë thënia: “Çdo përjashtim është edhe shfuqizim, ndërsa çdo shfuqizim nuk është përjashtim.” dhe kjo është edhe e vërtetë.

Dallimi në mes të shfuqizimit dhe të përcaktimit

Dijetarët e mëhershëm nuk e bëjnë dallimin në mes të përcaktimit dhe të shfuqizimit, ndërsa dijetarët e mëvonshëm e shohin si të patjetërsueshme dallimin në mes tyre.

Përcaktim, është fjala e cila e përcjell të papërcaktuarën, që e pakëson gjithpërfshirjen e saj.

Dallimi në mes të shfuqizimit dhe përcaktimit është si në vijim:

1. Teksti i të papërcaktuarës, pas përcaktimit mbetet i pakësuar brenda kornizës së ligjit dhe ligji as nuk është hequr dhe vazhdohet të punohet me të përderisa me shfuqizimin përfundon të vepruarit me të.

2. Lajmet e pranojnë përcaktimin përderisa shfuqizimi jo.

3. Përcaktimi ndodh për të kaluarën paralelisht me ligjin, por edhe më vonë se ligji, përderisa shfuqizimi ndodh vetëm pas ligjësimi. Kjo do të thotë se ligji i mëvonshëm vjen për të shfuqizuar.

Te Hanefijtë çdo përcaktim i mëvonshëm dhe çdo specifikim i mëvonshëm nuk konsiderohet shfuqizim.¹⁷ Vërehet se: Përcaktimi ka të bëjë me fjalën e papërcaktuar dhe tregon për një individ nga individët të cilët nuk janë të përcaktuar dhe nuk përcaktohet për shkak të një atributi prej attributeve. Shembull: njeri dhe njerëz, libër dhe libra. Përderisa specifikimi, bëhet nga fjala e përgjithshme, ajo është fjalë e cila përmbledh të gjitha njësitë pa i përkufizuar me ndonjë fjalë përgjithësuese. Shembull: Të gjithë, gjithsecili, shumësi me pjesëzën “EL” shquese për gjithëpërfshirje,

kushtorja, forma pyetëse, përemrat lidhorë siç janë fjalët e Zotit të Lartmadhëruar.

كُلُّ أَمْرٍ بِمَا كَسَبَ رَهِيْنٌ

“Secili njeri është peng i asaj që ka punuar.” (Et-Turë : 21)

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ

“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët...”

Tema e dytë: Mendimet e dijetarëve për shfuqizimin

Në çështjen e shfuqizimit, njerëzit janë ndarë në dy grupe:

- Ata të cilët e pranojnë shfuqizimin.
- Ata të cilët nuk e pranojnë shfuqizimin.

Në këtë rast, në rend të parë do ta sqaroj mendimin e jomuslimanëve, dhe në rend të dytë mendimin e muslimanëve.

E para: Shfuqizimi te ithtarët e librit (jehudët dhe të krishterët)

Është gjë e natyrshme që jehudët dhe të krishterët, logjikisht të mos e pranojnë shfuqizimin edhe pse praktikisht ka ndodhur. Për t'u mbrojtur klerikët e tyre në bazat e tyre dhe që feja e tyre të qëndrojë përballë islamit, me argumentimin e tyre se një shariatë nuk e shfuqizon një shariatë tjetër dhe një ligj i një sheriati nuk e shfuqizon një ligj të një sheriati tjetër dhe për shkak të parimit të tyre të mospranimit të shpalljes së fesë islame dhe me pretendimin e jehudëve se Musa a.s. ka thënë: **“Sheriati nuk shfuqizohet.”** dhe ka thënë **“Zbatojeni ligjin tim deri sa të jetë qielli dhe toka.”** Pastaj “Përmbajuni ditës së shtunë.” që do të thotë, adhurimin në këtë ditë dhe veprimin në çështje tjera përderisa të jetë qielli dhe toka. E vërteta është se asnjëra prej këtyre thënieve nuk është vërtetuar. Mazhoranca e jehudëve kanë këto tipare, ndërsa sa i përket shfuqizimit, ata janë ndarë në tri drejtime:

Shemunijet deklarojnë se, është absurde të ndodhë shfuqizimi logjikisht, por edhe që të transmetohet se ka ndodhë.

Ijsuvitët deklarojnë se, logjikisht shfuqizimi mund të ndodhë dhe juridikisht mund të ndodhë por sheriati i Muhamedit nuk e ka shfuqizuar sheriatin e Musës, por është posaçërisht për arabët, si pasardhës të Ismailit, dhe jo për të gjithë njerëzimin.¹⁸

Inanijet deklarojnë se, logjikisht shfuqizimi mund të ndodh, por pengesa është dëgjuar se ka ndodhë.

Mirëpo nëse hulumtohet në Tevratë, në shumë vende shihet se Zoti i Lartmadhëruar ka tërhequr ligje për ta, kur kanë qenë në vështirësi dhe kanë

pyetur pse janë tërhequr ato obligime, kështu që shfuqizimi nuk ka kuptim tjetër pos kësaj.

Ajo çka tregohet se është thënë prej Musait nuk është vërtetuar prej tij. Jehudët e kanë caktuar Ravandijun për ta kundërshtuar shpalljen e Muhamedit a.s.

Jehudëve të cilët nuk e pranojnë ndodhjen e shfuqizimit dhe nuk e lejojnë, mund të u kundërpërgjigjemi me argument se, Kur'ani është fjalë e Allahut. Vërtetimi i peygamberisë së Muhamedit a.s. dhe se peygamberia e tij është vërtetuar me argument të prerë dhe është mrekulli e Kur'anit e cila e vërteton se është vula e peygamberëve.

E dyta: Shfuqizimi në islam

Janë dakorduar muslimanët për vlerën e shfuqizimit në ligje dhe se logjikisht lejohet dhe juridikisht ka ndodhur, përpos çka është thënë prej Ebu Muslim el Esfehhanijut, i cili ka vdekur në vitin 322 h. dhe ai është mendim i izoluar, ose është vetëm një thënie prej dy thënieve prej tij se nuk ka ndodhur duke u arsyetuar (duke e interpretuar) se atë që shumica absolute e shohin se është shfuqizim është *skadim i ligjit me skadimin e kohës së tij* dhe kjo nuk konsiderohet shfuqizim.

E vërteta është se ajo çka është raportuar nga Esfehhaniju është se shfuqizimi ka ndodhur tek shariatet e njëra tjetrës, mirëpo nuk ka ndodhur brenda një shiati.

Kjo është në përputhshmëri me atë çka janë dakorduar muslimanët se shiati i Muhamedit a.s. është shfuqizues i të gjitha shariateve të mëparshme, që do të thotë, ligjet dytësore, dhe nuk mund asnjë musliman të kundërshtoj këtë ixhmaë.

Në vijim do të sqaroj argumentet.

Argumentet e shumicës absolute të dijetarëve dhe pranimi me rezervë i të tjerëve.¹⁹

Argumentet e shumicës absolute të dijetarëve

Për lejin e shfuqizimit, shumica absolute e dijetarëve janë argumentuar me argumente logjike dhe transmetuese:

1. **Sa i përket argumentit logjik.** Ndodhja e tij, nuk rezulton se ka ndodhur diçka absurde sepse ligjet e Allahut, në sheriatin e Tij edhe nëse nuk kanë të bëjnë me interesin e robërve, ajo e pason dëshirën e Allahut. Shfuqizimi është vepër e Allahut. Allahu vepron çka dëshiron dhe gjykon si të dëshiron. Ai ndonjëherë urdhëron një veprim në një kohë dhe e ndalon atë veprim në një kohë tjetër sikurse është çështja kur urdhëron agjërimin në ditët e ramazanit, ndërsa e ndalon agjërimin në ditën e bajramit.

Por, nëse shikohet nga këndvështrimi se ligjet e Allahut janë për dobinë e robërve të tij, siç thonë muëtezilët, nuk ka dyshim se interesat ndryshojnë me ndryshimin e personave dhe të kohëve sepse mund të jetë në interes për një person në një kohë, ndërsa nuk është në interes për një person tjetër ose për një kohë tjetër. Përderisa interesat ndryshojnë dhe ligjet në ligjësimin e tyre kujdesen për interesin e njerëzve, atëherë shfuqizimi është i mundshëm dhe nuk është absurditet dhe logjikisht është i lejuar.

2. **Sa i përket argumentit transmetues,** thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?” (El-Bekare : 106)

Ky ajet tregon se ligjërisht është e lejuar që shfuqizimi të ndodh nga ana e Allahut të Lartmadhëruar.

Argumenti i parë replikohet me atë se, shfuqizimi rezultohet absurditet, kështu që është absurde shfuqizimi dhe se ligji shfuqizues nëse është për dobi të cilën e ka ditur Allahu, llogaritet se nuk e ka ditur dhe ka ndodhur zbulimi, që do të thotë, zbulimi pas fshehtësisë dhe kjo nuk i përket Allahut të Lartmadhëruar sepse do të nënkuptonte harresën e Zotit të Lartmadhëruar. Por, nëse është ligjësuar për ndonjë interes, atëherë do të ishte tallje, e për Allahun tallja është absurde.

Replikë: Zoti i Lartmadhëruar e ka ligjësuar ligjin e shfuqizimit për dobi të cilën e ka ditur që nga fillimi i pafillim dhe në esencë nuk ka qenë e fshehur prej Tij, mirëpo koha e tij vjen në radhë kur të përfundon ligji i parë dhe atëherë kur përfundon interesi i pikësnyuar.

Argumenti i parë, gjithashtu është replikuar me atë se, po të lejohej shfuqizimi i ligjeve të shariatit, do të ndryshonte aspekti i interesit dhe do të lejohej çka është domosdoshmëri në çështjet e besimit dhe të njësimt, në cilësitë e Allahut dhe çka lejohet në ato cilësi, mirëpo kjo është e pavlefshme dhe absurde dhe e pavlefshme, e kështu çdo gjë që shpie në atë drejtim.

Replikë: Besimi në njësim dhe çdo gjë të cilën e tregon logjika, nëse vërtetohet me logjikë, siç thonë muëtezilët se e mira dhe e keqja janë çështje të logjikës, atëherë është absurde shfuqizimi për atë që është bërë obligim logjikisht sepse Ligjvënësi nuk sjell diçka jashtë logjike edhe nëse është vendosur me ligj sepse logjika nuk e parasheh që të mos jetë obligative besimi në njëshmërinë e Allahut dhe njëshmëria e Tij është që nga fillimi i bazës dhe nuk parashihet të shfuqizohet para obligueshmërisë së tij.

Replikohet argumenti i dytë me atë se, ligjërimi i cili shfuqizon ligjin ose mund të jetë i përkohshëm për një kohë të caktuar dhe ai nuk pranon shfuqizimin me kalimin e kohës së tij, atëherë duhet të tregoj për vazhdimësinë e përgjithmonshme, e shfuqizimi do të ishte absurd²⁰ sepse është e domosdoshme të jetë ashtu.

a. Bindja prej të ngarkuarit për vazhdimin e përgjithmonshëm të ligjit, e ajo është e kundërta e realitetit, atëherë ajo bindje është injorancë e keqe dhe çdo gjë e cila imponon të keqen është e keqe.

b. Ashtu siç nuk duhet pasur besim në premtimin për shpërbtim dhe kërcënimin për ndëshkim dhe kjo shkakton në mosbesimin ndaj ligjeve.

c. Po të lejohej tërheqja e ligjit pas aprovimit, atëherë, ose bëhet tërheqja para se të ekzistoj, pra paralelisht me zbatimin, ose pas ndodhisë dhe mosndodhisë së saj, pa hapësirë kohore, ose në momentin e ekzistimit të tij dhe ngjitjen me të që do të thotë, në momentin e obligueshmërisë.

Sa i përket të parës - në të nuk mund të paramendohet shfuqizimi sepse shfuqizimi deri sa të gjendet është i paimagjinueshëm.

Sa i përket të dytës - shfuqizimi prapë është i pamundur sepse është tërhequr e paekzistuar.

Sa i përket të tretës - në bazë të saj duhet të tërhiqet diçka që në momentin e ekzistimit dhe kjo është çështje kontradiktore me vet çështjen.

Replikë: Ligji i përcaktuar përkohësisht ndonjëherë shfuqizohet para skadimit të afatit dhe urtësia e saj është të sprovuarit e zbatimit dhe të devotshmërisë, ashtu siç ka ndodhur me rastin e Ibrahimit a.s. kur është urdhëruar të bëjë kurban djalin e tij, e më pastaj është shfuqizuar me prerje të kurbanit.

Sa i përket ligjit i cili tregon për përgjithmonshmëri, me shfuqizimin e tij nuk do të thotë bindje e kundërt me realitetin, ose mosbesueshmëri në perceptim për shpërblim dhe kërcënimin për ndëshkim prej Allahut sepse i ngarkuari kur të krijojë bindje për përgjithmonshmëri, ndërsa injoranca vjen prej vetes së tij, dhe jo prej ligjërimit të sheriatit, bile, e ka obligim të ketë bindje për përgjithmonshmëri, me kusht që të mos ketë shfuqizim. Nuk është e drejtë që të ketë paragjykim për të mos besuar premtimin e Allahut dhe kërcënimin e Tij, për shkak se do të ketë shfuqizim sepse premtimi dhe kërcënimi janë prej llojit të lajmërimeve, e lajmërimi nuk bën pjesë në sferën e shfuqizimit, por sfera e shfuqizimit ka të bëjë me ligjin dytësor të detyrave.

Argumentet e ndodhjes së shfuqizimit

Shumica absolute e dijetarëve të cilët deklarojnë se ka ndodhur shfuqizimi janë argumentuar me argumente të shumta, e prej tyre janë:²¹

1. **Ixhmai i sehabëve dhe dijetarëve të mëparshëm në atë se sheriat i Muhamedit a.s. i ka shfuqizuar të gjitha shariatet e mëhershme**, që do të thotë se i ka shfuqizuar, përpos pjesës së bazës së besimit dhe të moralit. Shembull: ndalesa e dhjavit (yndyrës) dhe çdo shpendi me kthetra shkoqës për jehudët, për shkak se ata bënë padrejtësi dhe hanin pasurinë e njëritjetrit padrejtësisht me kamatë dhe të ngjashme. Këtë e tregon ajeti kur'anor:

قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعُمُهُ إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً
أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ لَحْمَ خِنْزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ أَوْ فِسْقًا أُهِلَّ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ ۚ

“Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej diçka të ndaluar nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai i ndytë, dhe pos asaj që është therur jo në emër të All-llahut (por të ndonjë idhulli) e që është mëkat...” (El-En'am : 145)

2. **Ixhmai i shfuqizimit të domosdoshmërisë së kthyerjes në drejtim të Qabes, përderisa deri në atë kohë faleshin në drejtim të Mesxhidi Aksasë** dhe po ashtu ixhmai për shfuqizimin e testamentit për prindërit dhe familjarët me ajetet e trashëgimisë. Shfuqizimi i agjërimit të ditës së ashures me agjërimin e muajit të ramazanit. Shfuqizimi i obligueshmërisë së dhënies sadaka para takimit me pejgamberin s.a.v.s. me ajetin i cili ua falë nëse nuk veprojnë ashtu. Shfuqizimi i qëndrimit një vit në shtëpinë e burrit të saj të gruas së cilës i vdes burri me IDDETIN e katër muaj e dhjetë ditëve.

3. **Është vërtetuar në Tevratë dhe në libra tjerë, lejimi i martesës së vëllait me motrën në shariat e Ademit a.s.**, pastaj është shfuqizuar në të gjitha shariatet. Po ashtu ka qenë ligj në Tevratë lejimi i çdo ushqimi përpos gjakut në shariat e Nuhut a.s. Pastaj janë ndaluar shumë kafshë në shariat e Musait a.s. e cila tregohet në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَعَلَى الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا كُلَّ ذِي ظُفْرٍ

“E (posaçërisht) ndaj atyre që janë jehudi. Ne kemi ndaluar çdo (kafshë) thundrake.” (El-En’am : 146)

Është replikuar argumenti i parë me atë se sheriatu i Muhamedit a.s. nuk e ka shfuqizuar çdo gjë të sheriateve qiellore të mëparshme.

Replikë: Na mjafton neve deklarimi se ekziston shfuqizimi i një pjese të atyre sheriateve për të pasur argument se shfuqizimi ka ndodhur.

Replikohet argumenti i dytë, se kthimi në drejtim të Mesxhidi Aksasë, apo qëndrimi njëvjeçar nuk është tërheq në tërësi. Edhe sot njeriu nuk duhet të kursejë asgjë për të shkuar në Mesxhidi Aksa dhe kjo është e ligjësuar, dhe qëndrimi bëhet një vit nëse gruaja është shtatzënë. Çështja është se është se është vetëm një lloj specifikimi.

Replikë: Kjo ka qenë vaxhib, pastaj është shfuqizuar në tërësi. Urdhri për kthyerje në drejtim të Mesxhidi Aksasë, ka pasur të bëjë me namazin, e pastaj është shfuqizuar. Ideti i femrës, një vit i plotë, në esencë nuk veprohet, sepse ideti i rinovimit është idet i shtatzënës dhe jo idet i njëviteshit.

Replika për obligueshmërinë e dhënies sadaka është tërheqë pasi që nuk ka ekzistuar shkaku, e ajo është bërë për të dalluar besimtarin prej munafikut. Kur janë kuptuar (dalluar) është tërheqë ligji me largimin e arsyes së tij dhe kjo nuk quhet shfuqizim.

Replikë: Në esencë vazhdon shkaku, ashtu siç edhe nuk ka qenë shkaku i vërtetë sepse kjo do të nënkuptonte se çdo sehabë i cili nuk ka dhënë sadaka, ka qenë munafik sepse nuk ka dhënë asnjë prej tyre përpos Aliut r.a. Edhe pse mosdhënia e sadakasë së tjerëve pos Aliut r.a. ka qenë se nuk kanë dashur të takohen dhe të bisedojnë në vetmi me të dhe nuk gjykohen se kanë qenë munafikë. Por edhe po të pranohet se arsyeja ka qenë për t’i dalluar, nuk e pranojmë se është mënjeluar shkaku sepse munafikët nuk janë dalluar edhe deri në vdekjen e Muhamedit a.s.

Replikë e argumentit të tretë – Është e lejuar të ketë qenë e ligjësuar për Ademin dhe Nuhun a.s. deri në kohën e caktuar, pra deri në paraqitjen e sheriateve tjera apo në shtimin e pasardhësve (njerëzimit), etj., dhe është tërhequr ligji dhe për shkak të mënjanimi të shkakut nuk quhet shfuqizim. **Replikë:** Ligjësimi është që të jetë i vazhdueshëm dhe të veprohet me të dhe nuk ka qenë për qëllim përcaktimi dhe kur të afrohet diçka çka e kundërshton atë që është e përgjithmonshme, ajo quhet shfuqizim dhe nuk

ka të bëjë me atë çka është dituri e Allahut sepse po të konsiderohej dituri, në esencë nuk do të kishte pasur as shfuqizim.

Argumentet e Ebu Muslim el Esfehanijut

Ebu Muslim el Esfehaniju është prej dijetarëve komentues të Kur'anit të shek. IV të hixhretit. Ka vdekur në vitin 322. Ai absolutisht e ka lejuar shfuqizimin por nuk e ka pranuar se ka ndodhur duke u arsyetuar si në vijim:²²

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar për cilësinë e Kur'anit:

لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ ۚ تَنْزِيلٌ مِّنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ

“Atij nuk mund t’i vishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të lavdishmit.” (Fusilet : 42)

Po të ndodhte shfuqizimi në Kur’an, do të na paraqitej e pavërteta sepse shfuqizimi përmban tërheqjen e ligjit të shfuqizuar, e kjo është e pavërtetë sepse me këtë do të përgënjeshtrohej informata e Allahut të Lartmadhëruar, ndërsa është absurde të përgënjeshtrohet informata e Tij.

Në lidhje me argumentimin e ajetit është replikuar në tri mënyra

E para: Shfuqizimi është i pavlefshëm. Këtu nuk ka pavlefshmëri sepse shfuqizimi është vërtetësi dhe sinqeritet. E pavërteta është e kundërta e së vërtetës. E gjithë çka ka të bëjë çështja është se ligji i shfuqizuar bëhet joaktiv (i papërdorshëm). Ajeti nuk tregon atë që po e kërkon Esfehaniju.

E dyta: Përemri vetorë në ajetin e mëposhtëm:

“Atij nuk mund t’i vishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.” (Fusilet : 42)

kthehet në Kur'anin në tërësi, që do të thotë se nuk shfuqizohet i tërë Kur'ani dhe për këtë janë dakorduar dijetarët.

E treta: Kuptimi i ajetit është se këtij libri nuk i ka parapri libër prej Allahut i cili e bën të pavlefshëm dhe nuk do të vjen pas tij çka e bën të pavlefshëm dhe kjo nuk e mohon që të vjen në vet Kur'anin, që të zhvlerëson diçka prej vetes së saj. Kështu pra, nuk ka argumentim prej ajetit i cili tregon për atë që pretenduesi kërkon.

Tema e tretë: Sfera e shfuqizimit dhe kushtet e saj

Sfera e shfuqizimit

Është çdo ligj i sheriatit të cilin nuk pason përgjithmonshmëria dhe as e përkohshmja. Nga kjo përjashtohen ligjet logjike dhe shqisore, dhe informatat për çështjet e kaluara, ose për ngjarjen e tanishme apo për të ardhmen, gjë që do të shkaktonte gënjeshtëri ose injorancën.

Qëllimi me pjesën “i përgjithmonshëm” është që të jetë i vazhdueshëm, deri sa të ekzistoj koha e obligueshmërisë, e ajo është kjo botë.

Sa i përket informatave për lejimin apo ndalimin e diçkaje, si p.sh., kjo është hallall dhe kjo është haram, pranohet të jetë shfuqizim. Kështu deklarohen Hanefijtë, po ashtu edhe Shafijtë, mund të shfuqizohet ajo çka e tregon informata, nëse tregueshmëria është për të treguar ligj obligativ të sheriatit. Nëse nuk është kështu, nuk është shfuqizim.²³

Bazuar në këtë, të gjitha ligjet nuk pranojnë shfuqizim. Disa prej ligjeve pranojnë shfuqizimin, e disa nuk pranojnë. Për këtë arsye dijetarët kanë paraparë kushtet e shfuqizimit, e për disa kushte janë dakorduar, e për disa tjera nuk janë dakorduar. Më të rëndësishmet prej tyre janë shtatë:

1. **Që të jetë ligj i cili e pranon shfuqizimin.** Që e mira, ose e keqja të jetë prej çështjeve të cilat mund të bien, përderisa çka nuk pranojnë të bien, nuk lejohet shfuqizimi, ashtu që të jetë prej ligjeve bazike, aty nuk lejohet shfuqizimi, si p.sh., ligjet që ndërlidhen me bazat e fesë dhe të besimit, e çështjet e ngjashme logjike. Shembull: Bindja në njëshmërinë e Allahut dhe besimi në të, urrejtja e mosbesimit sepse Zoti i Lartmadhëruar me të gjitha cilësitë e tij, ka qenë dhe do të jetë.

Shembuj tjerë: Besimi në Ditën e Kijametit, në melaqet, në librat dhe në pejgamberët dhe të gjitha bazat e besimit dhe adhurimeve dhe parimeve islame, bazat e vlerave dhe jovlerave, si f.v., sinqeriteti, amaneti, drejtësia, burrëria, gënjeshtria, tradhtia, padrejtësia, shëmtia, imoraliteti, e të ngjashme, të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e popujve dhe të gjeneratave.

Ky kusht është te mu'etezilët dhe Maturidijtë. Këtë kusht nuk e parashohin Esharijtë sepse mirësitë e ligjeve të shariatit që të gjitha janë edhe të besimit edhe të praktikimit, dhe ato janë gjenerim i ligjit.²⁴

Ligjet të cilat nuk pranojnë shfuqizim janë tri:

a. **Ajo çka mësohet qartë prej tekstit se është e përgjithmonshme**, si p.sh., fjala e Zotit të Lartmadhëruar:

خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا

“Gjithmonë do të qëndrojnë në të, pa përfundim.” (En-Nisa : 57)

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në çështjen e atyre të cilët kanë besuar Muhamedin s.a.v.s.:

وَجَاعِلُ الَّذِينَ اتَّبَعُوكَ فَوْقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۚ

“E ata që të besuan ty, do t’i ngriji lart mbi ata që nuk besuan deri në ditën e kijametit.” (Ali Imran : 55)

dhe shembulli tjetër: obligimi i xhihadit në rrugën e Allahut në hadithin e pejgamberit s.a.v.s.: **“Xhihadi është i vazhdueshëm prej kohës kur më ka dërguar Allahu dhe deri kur i fundit i këtij umeti të luftoj dexhallin.”**²⁵

b. **Ajo çka është ligjësuar me tregueshmëri të përgjithmonshme**, shembull, ligjet e pejgamberisë së Muhamedit s.a.v.s. i cili është ngrirë si ligj i përgjithmonshëm, ai ligj është i përgjithmonshëm dhe nuk pranon shfuqizim, me tregueshmërinë se Muhamedi s.a.v.s. është vula e pejgamberëve, nuk ka pejgamber pas tij, dhe nuk ka shfuqizim përpos prej shpalljes së fjalëve të tij.

c. **Çka ligjësohet për një afat të caktuar**, shembull, nëse Ligjvënësi thotë: “U lejoj juve që të veproni këtë, deri sa të kaloj një vit.” Nuk lejohet shfuqizimi para atij afati sepse ligji skadon me skadimin e atij afati, dhe shfuqizimi para kësaj kohe është gabim dhe zbulim imagjinar për Allahun e

Lartmadhëruar. Nuk ka raste të tilla në tekste të sheriatit. Sa i përket thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَا تَقْرُبُوهُمْ حَتَّىٰ يَطْهَرُوا

“Dhe mos ju afroni atyre derisa të pastrohen.” (El-Bekare : 222)

dhe thënia e Tij:

۞ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ

“Dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje...” (El-Bekare)

Qëllimi është ndalimi i afrimit në kohën e menstruacionit dhe ligjësimi i ngrënies dhe pirjes gjatë natës, kjo nuk është e përkohshme, por është ligjësim absolut.

Dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket lejimit të shfuqizimit të ligjeve të cilat janë të përgjithmonshme dhe të përkohshme.

Shumica absolute e dijetarëve, e prej tyre Shafijjtë, muëtezilët dhe një grup i Hanefijëve deklarojnë se, lejohet shfuqizimi edhe i ligjeve të përgjithmonshme edhe i të përkohshmeve, të cilat kanë të bëjnë me urdhëresat dhe ndalesat sepse ndonjëherë nga ana e jashtme e ligjërimit duket se ka të bëjë me përgjithmonshmërinë, pra për të gjitha kohët, për shkak të kuptimit të përgjithshëm. Përderisa ligjërimi ka pikësynim ligjësimin e ligjit për në disa kohëra, dhe nuk ka për qëllim në kohëra tjera dhe se zakonisht në shprehjen për “përgjithmonë” të urdhrit përdoret edhe si formë hiperbole dhe jo në kuptim të drejtë *përgjithmonë*.

Shumica e Hanefijëve deklarojnë se nuk lejohet shfuqizimi në ligjësim të përgjithmonshëm dhe të përkohshëm sepse nëse i japim ligjërimit përcaktim të së përgjithmonshmes dhe të përkohshmes do të na shpinte në kundërthënie dhe në imagjinatë, ndërsa Ligjvënësi është i pastër nga kjo e metë dhe nuk lejohet të thuhet se mund të shfuqizohet sepse e përkohshmja është në nivelin e specifikimit për çdo kohë prej kohëve të kohës së specifikimit të saj, ndërsa shfuqizimi nuk ka të bëjë me atë proces sepse janë dakorduar të gjithë për këtë dhe pikësynimi i ligjërimit të përgjithmonshëm

me karakter të përkufizimit është vetëm metaforë dhe nuk mund të definohet pa pasur ndonjë dëshmi. Ekzistenca e *përgjithmonshmërisë* është pengesë për t'u shfuqizuar. Ky është edhe mendimi prioritar.

2. **Që e shfuqizuara të jetë ligj sheriatik (juridik) dhe jo logjik.** Ajo çka është bazë e bazave natyrore nuk llogaritet shfuqizim, si f.v., obligueshmëria e adhurimeve. Ky është mendim i shumicës së dijetarëve, shumica e Hanefijëve deklarojnë se tërheqja e së lejuarës bazike është shfuqizim sepse të Hanefijtë e lejuara bazike është shfuqizim sepse të Hanefijtë e lejuara bazike është fuqizuar me sheriatë sepse njerëzit e kanë praktikuar në mënyrë konstante, në një kohë prej kohëve dhe tërheqja e atij veprimi është shfuqizim dhe nuk është absurditet.²⁶

3. Po ashtu janë pajtuar se ligjërimi i cili përmban informata për çështjet e kaluara apo ditore apo për të ardhmen, gjë që shpie në shfuqizimin e gënjeshtres apo injorancës, nuk mund të shfuqizohet sepse rezulton përgënjeshttrim apo lëshim. Dhe e gjitha kjo për Allahun është absurditet.²⁷ Mirëpo nëse tregueshmëria e informatës është ligj i sheriatit për t'u zbatuar si f.v., kjo është hallall dhe kjo është haram, atëherë lejohet shfuqizimi.

Dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme, nëse informata është e llojit prej informatave të cilat ndryshojnë, pa marrë parasysh a është informatë e së kaluarës, si f.v., është vërejtur besimi i Zejdit dhe mosbesimi i tij, ose për të ardhmen, pa marrë parasysh a është informatë kërcënimi apo premtim shpërblimi, apo ligj sheriativ.

Një pjesë e mutekeliminëve dhe fukahave mendojnë se nuk lejohet shfuqizimi dhe tërheqja sepse do të nënkuptonte harresën dhe gënjeshtren për Zotin e Lartmadhëruar.

Shumica absolute e dijetarëve dhe këtë mendim e favorizon edhe Amediju, mendojnë se lejohet shfuqizimi dhe tërheqja e tij, sepse informata edhe nëse është e përgjithshme lejohet që shfuqizuesi ta sqaroj heqjen e një pjese të asaj që e përfshinë fjala. Këtë do ta sqaroj në temën “shfuqizimi i informatave”.

4. **Që shfuqizimi të jetë ligjërim sheriatik.** Nuk llogaritet si shfuqizim tërheqja e ligjit me vdekjen e të ngarkuarit, por llogaritet lirim nga obligueshmëria. Për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët.²⁸

5. **Që Shfuqizuesi të jetë i ndarë nga e shfuqizuara.** Kjo do të thotë se duhet të jetë i mëvonshëm, deri sa të sqarohet esenca e tërheqjes së ligjit.

Po të ishte i ngjitur ose i bashkëngjitur si f.v., kushti, cilësia dhe përjashtimi, nuk quhet shfuqizim, por është specifikimi dhe sqarimi i ligjit të parë. Për këtë kusht janë dakorduar dijetarët.

6. Që shfuqizuesi të jetë i të njëjtit nivel të së shfuqizuarës për nga ana e fuqisë edhe më i fuqishëm. Nëse është më i ulët në fuqi nuk është i vlefshëm sepse e dobëta nuk mund ta largon të fortën.

7. Që e shfuqizuara të mos përcaktohet me afat të caktuar. Nëse do të ishte kështu, koha pas asaj kohe të përcaktuar nuk do të ishte shfuqizim i saj.

Shfuqizimi para mundësisë së kryerjes së veprimit

Kjo temë ndërlidhet me kushtin e mëhershëm për të cilin janë dakorduar dijetarët, e ai kusht është vonimi i ligjit shfuqizues ndaj ligjit të shfuqizuar.

Janë dakorduar dijetarët, në bazën e së cilës lejohet shfuqizimi, pasi që të ketë mundësi të kryej veprimin me të cilin është i ndërlidhur ligji pasi ta kuptoj ngarkesën, dhe kjo pasi që të kaloj një kohë e caktuar, në të cilën ka mundësi ta kryej veprimin.

Po ashtu janë dakorduar në atë se lejohet shfuqizimi pasi të bindet për të shfuqizuarën dhe për të vepruar me të, pa marrë parasysh a e veprojnë të gjithë njerëzit, si f.v., në kthimin nga drejtimi i Mesxhidi Aksasë apo një pjesë prej tyre, si f.v., obligueshmëria e dhënies sadaka para takimit me të dërguarin s.a.v.s.

Kanë dhënë mendime të ndryshme në shfuqizimin e ligjit (obligueshmërinë apo formë tjetër) para veprimit, që do të thotë, shfuqizimi i veprimit të përkohshëm para se të hyn koha, ose pasi që të hyn koha, por nuk ka mundësi që ta kryej atë veprim, ose shfuqizohet veprimi i cili nuk përcaktohet me kohë të kufizuar, e që e kërkon menjëherë (shfuqizimin) dhe nuk ka mundësi të kryej veprimin, sikurse f.v., kur Xhibrili e mëson peygamberin s.a.v.s. për obligueshmërinë e një çështjeje për umetin, pastaj shfuqizohet ai ligj para se t'ua mësoj, si f.v., kur Ligjvënësi thotë: Pas perëndimit fali dy rekate, pastaj thotë: Lavdëroje Allahun dhe mos u fal, ose thotë: Kryejeni haxhin këtë vit, pastaj para se të shkohet në Arafat të thuhet: Mos e kryeni haxhin. Tema për këtë çështje është vetëm teori për debat, është çështje e ngarkesës për të pamundurën:

- **Shumica absolute e dijetarëve thonë lejohet.**
- **Shumica absolute e muëtezilëve thonë se nuk lejohet ligji,** por lejohet vetëm atëherë kur ekziston një hapësirë kohore për ta kryer obligimin.
- **Hanefijtë thonë:** Kushtëzohet që të kenë mundësi ta pranojnë detyrën dhe të binden dhe nuk kushtëzohet që të ketë hapësirë kohore për të vepruar, sepse bindja (pranimi i detyrës) është bazë e kryerjes së detyrave dhe të adhurimeve. Dhe kjo mund të pasqyrohet që shfuqizuesi ka qëllim që pasi që të ketë mundësi të bindet para se të hyj koha e obligueshmërisë.

Secili prej tyre i ka argumentet si në vijim:²⁹

E para: Argumentet e shumicës absolute të dijetarëve.

Shumica absolute e dijetarëve janë argumentuar me argumente të shumta, më të rëndësishmet janë dy: logjik dhe transmetues praktik.

1. **Argumenti logjik:** Për këtë lloj shfuqizimi nuk ka pengesë, as logjikisht as ligjërisht, sepse ekziston mundësia, e ajo është: tërheqja e detyrës e cila ka qenë e paraparë për të ngarkuarin dhe kjo është shfuqizim dhe kjo nuk nënkupton imagjinatë dhe as absurditet, sepse interesi i cili parashihet që për shkak të saj është i lejuar shfuqizimi, pas mundësisë së veprimit dhe pas hyrjes së kohës, lejohet të merret parasysh (se mund të ndodh shfuqizimi) para mundësisë së veprimit dhe para se të hyjë koha dhe dobia e kësaj është që të sprovohet i ngarkuari dhe të testohet bindja e tij dhe përgatitja për t'i kryer detyrat, për t'i dëgjuar urdhrat dhe për të qenë të vëmendshëm.

2. **Argumenti praktik:** Ekzistojnë shembuj praktik për shfuqizimin e ligjit para se të ketë mundësi të kryhet ligji i shfuqizuar e prej tyre janë:

Obligimi i namazit në Miëraxh. Zoti i Lartmadhëruar ia ka bërë obligim Muhamedit a.s. për umetin e tij pesëdhjetë kohë të namazit brenda një dite e një nate, pastaj janë shfuqizuar dyzetë e pesë namaze dhe kanë mbetur pesë namaze, para se të kishte mundësi që i dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe umeti i tij t'i falte, për shkak se nuk ka hy koha e obligueshmërisë dhe para se të dijë umeti për obligueshmërinë, mirëpo ky argument është replikuar me argumentin se kjo nuk është bosht i debatit dhe nuk llogaritet si argument, sepse shfuqizimi ka qenë pasi që është mësuar pejgamberi s.a.v.s., i cili

është njëri prej të obliguarve, sepse nuk është kusht që të gjithë të obliguarit të dinë.

Argument tjetër: Tregimi i kurbanit. Zoti i Lartmadhëruar e ka urdhëruar Ibrahimin a.s. për bërje kurban djalin e tij, pastaj është shfuqizuar para se ta bën kurban, kjo do të thotë se është bërë shfuqizimi para kryerjes së veprimit (para mundësisë së kryerjes së veprimit).

Replikë: Hanefijtë e replikojnë këtë argument duke thënë se këtu nuk kemi të bëjmë me shfuqizimin, por Ibrahim i ka lënë këtë veprim të sakrificës sepse sakrificë është diçka e zë vendin e një sendi kur nuk mund të kryhet, siç është rasti me dispozitën e mbetjes së obligueshmërisë së agjërimit në të drejtë të plakut kur i është obliguar kompensimi (sakrifica) material dhe nuk thuhet: obligimi i kompensimit është shfuqizim sepse nuk është konfirmuar tërheqja e ligjit të parë dhe fuqizimin e ligjit të dytë.

Ashtu siç është replikuar argumenti nga muëtezilët, se urdhri i prerjes ka qenë nëpërmjet ëndërrimit, ndërsa është replikuar me atë se ëndrrat e pejgamberëve janë të vërteta dhe frymëzim.

Replikohet: Ibrahim i a.s. e ka kryer urdhrin e prerjes, e ka zbatuar urdhrin duke e vendosur thikën në qafën e të birit, mirëpo çdo prerje në fyt ka arritur tek Allahu.

Replikohet: Po të kishte ndodhur kështu nuk do të kishte pasur nevojë për kurban, sepse kurban (dashi) është zëvendësim i sakrificës e zëvendësimi vjen në pyetje kur nuk kryhet e zëvendësuar, përpos kësaj nuk është vërtetuar me argument të prerë se i ka arritur çka ka prerë, gjë që dëshmon se nuk ka ndodhur.

E treta: Argumentet e muëtezilëve.

Muëtezilët janë argumentuar se shfuqizimi i ligjit para se të kryhet është absurditet në vete sepse ky shfuqizim rezulton absurditetin sepse urdhri për diçka nënkupton mirësinë e saj ndërsa ndalesa e saj po në atë kohë nënkupton të keqen e saj dhe kjo do të ishte bashkimi i dy të kundërtave sepse do të ishte i njëjti veprim, nga i njëjti person, në të njëjtën kohë edhe të mirën edhe të keqen, ndërsa bashkimi i dy të kundërtave është absurditet.

Shumica absolute e replikojnë këtë argument. E mira dhe e keqja nuk janë bashkuar me të njëjtin veprim në të njëjtën kohë, por koha e urdhërimit është në një kohë tjetër ndërsa koha e ndalesës në një kohë tjetër, dhe nuk rezulton bashkimi i dy të kundërtave, mirëpo nëse ndryshojnë kohët dhe ekzistojnë kundërshtimet në mes të dy cilësive në fjalë.

Nuk pranohet replika e mëparshme e muëtezilëve vetëm se mbi bazën se është urdhëruar nga Ligjvënësi dhe jo prej diturisë së Tij për të mirën e saj, por testim i devotshmërisë së të ngarkuarit dhe testimin e vendosmërisë për kryerjen e detyrave.

Shfuqizimi i zëvendësimit

Shumica absolute e ekspertëve të usulit deklarojnë se nuk kushtëzohet që shfuqizimi të ndryshoj nga zëvendësimi.

Shevkaniju deklaron se kjo është e vërtetë dhe nuk ka çka të fshihet dhe se ka ndodhur shfuqizimi në këtë shariatë të pastër për çështjet e njohura dhe jo në zëvendësim.³⁰

Janë argumentuar me dy argumente:

E para: Ajo çka e tregon lejimi logjik, sepse nëse presupozojmë këtë, logjikisht nuk do të rezultonte se ka ndodhur diçka absurde. Kjo quhet argument se logjikisht është i lejuar dhe se Zoti i Lartmadhëruar vepron çka të dëshiron, se ndonjëherë interesi prej ligjit mund të jetë edhe pa zëvendësimin e tij.

E dyta: Ajo çka e tregon lejimin shariatik. Kur tërhiqet ligji dhe shfuqizohet pa zëvendësim, si f.v., shfuqizimi i ligjësimit të dhënies sadaka para takimit me pejgamberin s.a.v.s., pastaj shfuqizimi i konservimit të kurbanave, shfuqizimi i ndalimit të kontaktimit gjatë natës në ramazan me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

فَالآنَ بَاشِرُوهُنَّ

“Dhe tani kontaktoni me to.” (El Bekare : 187)

Pastaj shfuqizimi i ngritjes nga gjumi dhe qëndrimi deri në imsak në muajin ramazan. Shfuqizimi i faljes natën për Muhamedin a.s., shfuqizimi i idetit të një viti për gruan të cilës i vdes burri i saj, kjo do të thotë plotësimi i vitit për një vit është shfuqizuar pa zëvendësim dhe gruas i mjafton që ajo të qëndrojë në idet katër muaj e dhjetë ditë dhe kjo nuk është zëvendësim sepse zëvendësimi duhet të jetë i barabartë me të zëvendësuarën.

Disa muëtezil dhe disa dhahirijë deklarojnë (edhe Shafiiu e përkrah në librin err-Risale) se duhet të kushtëzohet që ligji shfuqizues duhet të zërë vendin e ligjit të shfuqizuar. Argument për këtë e sjellin thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِنْهَا أَوْ مِثْلَهَا ۗ أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ
عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?” (El Bekare : 106)

Patjetër që ligji shfuqizues të jetë më i mirë se ligji i shfuqizuar ose i njëjtë (i ngjashëm).

Replikohet me atë se, kjo nuk tregon boshtin e debatit sepse ajeti tregon shfuqizimin e fjalës dhe nuk tërhiqet ajeti, vetëm nëse e zëvendëson ajeti më i mirë në qartësim, alegori dhe metaforë, dhe nuk është kundërshtimi këtu për shfuqizimin e “fjalëve” por për shfuqizimin e ligjeve.

Po të ishte qëllimi i ajetit për ligjin e saj, atëherë mund të thuhet se rënia e ligjit të shfuqizuar është më i mirë në atë kohë ose që veprimi është ngritur në nivelin e lejimit ku mund të zgjidhet të veprohet ose të mos veprohet dhe kjo është më e dobishme (më e mirë).

Lloji i zëvendësuesit në argumentin e shfuqizuesit

Nëse shfuqizimi ndodh me zëvendësues të ngjashëm, lejohet që zëvendësuesi të jetë në kategori më të dobët se e shfuqizuara ose i barabartë me të, ose më e rëndë në barrë të të ngarkuarit.

Mirëpo, dijetarët e usulit janë dakorduar në lejimin e shfuqizimit zëvendësues të barabartë ose më të dobët.

Shembull i të parës: Shfuqizimi i kthimit nga Mesxhidi Aksaja në drejtim të Qabes.

Shembull i të dytës: Shfuqizimi në idet prej qëndrimit një vjeçar në qëndrim të katër muajve e dhjetë ditëve. Por nuk janë pajtuar në shfuqizimin prej më të lehtës në më të rëndën (ose më të vështirë).³¹

Shumica absolute e dijetarëve e lejojnë një shfuqizim të tillë sepse detyrimet janë për të siguruar interesat. Interesi mund të jetë në ligjësimin e ligjit më të vështirë pas ligjësimit të ligjit më të lehtë.

Shevkaniju thotë: E vërteta është se lejohet dhe ka ndodhur.

Shembull: Shfuqizimi i ndalimit të luftës në fillim të islamit me obligimin e mëvonshëm, dhe shfuqizimi i zgjedhjes së agjërimit i cili ka qenë në fillim të islamit dhe fidjes (kompensimit) material³² të tij me obligueshmërinë e agjërimit. Shfuqizimi i lejimit të alkoolit me ndalimin e tij. Shfuqizimi i martesës së përkohshme pas lejimit të saj. Shfuqizimi i ditës së Ashures me agjërimin e muajit ramazan. Shfuqizimi i dënimit të prostitutës me izolimin e tyre në shtëpi të tyre dhe mosdënimit prej burrit në atë mënyrë por me shkopinj dhe internim të beqarit dhe gurëzimit të martuarit. Të gjitha këto ligje janë më të rënda se të parat.

Shafiijtë dhe dhahirijtë deklarojnë se: Nuk lejohet shfuqizimi me zëvendësues më të rëndë se e shfuqizuara, në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُخَفِّفَ عَنْكُمْ ۖ وَخُلِقَ الْإِنْسَانُ ضَعِيفًا

“All-llahu dëshiron t’ju lehtësoj (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paaftë (për t’ju përballuar epsheve).” (En-Nisa : 28) dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِّنْهَا أَوْ مِثْلَهَا ۗ أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?” (El-Bekare : 106)

Zoti i Lartmadhëruar e ka përkufizuar zëvendësuesin që të jetë më i mirë ose i ngjashëm, ndërsa më e rënda nuk mund të jetë e ngjashme ose më e mirë dhe nuk ndodh kështu lloj zëvendësimi në shfuqizim dhe nuk ka shfuqizim të tillë.

Replikë – Qëllimi me lehtësim dhe butësinë është për botën tjetër. Lehtësimi është lehtësim i llogaridhënies në botën tjetër, butësia është masë zbutëse e llogaridhënies, por e vërteta është se ajeti i lehtësimit ka ardhur në kontekst të ligjësimit me martesën e robëreshës, nga kujdesi se e ka të vështirë të martohet me të lirë. Si përkujdesje ndaj gjendjes së të dobëtëve dhe interesave specifike të tyre. Ajeti i lehtësimit ka zbritur në kontekst të lehtësimit të të sëmurëve dhe udhëtarëve për mosagjërime dhe agjërimin kada

në ditë tjera. Kjo tregon se ata janë të dobët me atë përgjigje dhe nuk mbetet kundërpërgjigje tjetër përpos argumentimit se ka ndodhur shfuqizimi në shariat islam prej ligjit më të lehtë në ligj më të vështirë, gjë që ndikon në interpretimin e ajeteve në interpretim të largët.

Mund të thuhet se, ligji i ri kur të krahasohet me ligjet tjera, jo me ligjin e shfuqizuar, ai është i lehtë dhe i butë, ashtu siç dihet se ajeti i lehtësimit nuk ka përgjithësim, por është i papërcaktuar dhe mund të lehtësohet qoftë në disa ligje, që do të thotë se, në mënyrë globale ligjësimi vjen me qëllim të lehtësimit dhe është i ndërtuar mbi bazën e lehtësimit dhe tolerancës.

Për ajetin e tretë:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِّنْهَا أَوْ مِثْلَهَا

“Ne nuk shfuqizojmë asnjë nga argumentet tona apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të.” (El-Bekare : 106)

se është e mundur që dobia të jetë në ligjin më të rëndë sepse në të mund të fitohen shpërblime më të mëdha, duke u vërtetuar thënia e Muhamedit a.s.: **“Veprat më të vlefshme te Allahu, janë më të vështirat.”** dhe po ashtu thënia drejtuar Ajshes r.a.: **“Shpërblimi yt është në bazë të aftësisë tënde.”** Ose që dobia shihet në bazë të interesit i cili rezulton, në të shumtën e rasteve interesi i njerëzve është nga vepra e vështirë.

Tema e katërt: Llojet e shfuqizimit në argumentet e shariatit

Kërkohet që në rast shfuqizimi, shfuqizuesi të jetë më i fuqishëm se e shfuqizuara, ose e fuqishme sa është e shfuqizuara, dhe nuk shfuqizohet me më të dobëtën. Bazuar në këtë deklaramë se:

Janë pajtuar se lejohet të shfuqizohet teksti i Kur'anit me Kur'an. Suneti mutevatir me sunetin mutevatir. Transmetimi i vetmuar me transmetimin e vetmuar ose me sunetin mutevatir.

Te shumica e dijetarëve lejohet shfuqizimi i sunetit mutevatir me transmetimin e vetëm.

Shafiijtë e mohojnë se mund të ndodhë dhe thonë: “Nuk shfuqizohet Kur’ani me sunet dhe as suneti me Kur’an. Nuk lejohet ixhmai me ixhmaë dhe nuk shfuqizohet Kur’ani dhe suneti me kijasë.”

Nga kjo që u përmend dhe u sqarua në detaje shihet qartë se dispozita e shfuqizimit përfshinë shfuqizimin në mes të teksteve të Kur’anit dhe sunetit, pastaj dispozita e shfuqizimit të argumenteve të cilat nuk janë prej teksteve siç janë: ose ixhmai, ose kijasi, ose interesi.

E para: Shfuqizimi i Kur’anit me Kur’an

Dijetarët janë dakorduar se nuk lejohet shfuqizimi i gjithë Kur’anit, sepse mrekullia e sistemit të tij është e përhershme dhe e përgjithmonshme dhe se ligjet e tij përfshijnë ligjet e fundit ligjësuere dhe tërheqja e sheriatit është e palogjikshme dhe njerëzit nuk lihen pa sheriat.

Kërkohet që të mos ekzagjerohet në ekzistimin e shfuqizimit të disa ajeteve të Kur’anit, çdo herë kur mund të harmonizohen tekstet në mes vete, sepse ndonjëherë dijetarët e quajnë shfuqizim, ndërsa kanë për qëllim specifikimin apo përcaktimin. Për këtë arsye vendet e shfuqizimit të Kur’anit në shfuqizimin e një pjese të Kur’anit me një pjesë tjetër të Kur’anit janë të pakta dhe të thukëta.

Përpos kësaj dijetarët nuk janë dakorduar në shfuqizimin e Kur’anit me Kur’an, ndërsa shumica absolute e dijetarëve e kanë lejuar. Ebu Muslim el-Esfehanij e ndalon dhe nuk e pranon se është e lejuar.³³

Mendimi i shumicës absolute të dijetarëve

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë: Lejohet shfuqizimi i një pjese të Kur'anit, për shkak të diturisë së prerë në të dhe obligueshmërisë së të vepruarit me të dhe obligueshmërisë së të vepruarit me të dhe se në fakt ka ndodhur shfuqizimi në Kur'an, siç u sqarua më herët, me argumentimin si në vijim:

a. shfuqizimi i ajetit të testamentit për prindërit dhe familjarët:

كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدُكُمُ الْمَوْتُ إِن تَرَكَ خَيْرًا الْوَصِيَّةُ لِلْوَالِدَيْنِ
وَالْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ ۖ

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejtë. Për ata që janë të devotshëm.” (El-Bekare : 180)

me ajetet e trashëgimisë:

لِّلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ
وَالْأَقْرَبُونَ مِمَّا قَلَّ مِنْهُ أَوْ كَثُرَ ۚ نَصِيبًا مَّفْرُوضًا

“Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).” (En-Nisa : 7)

b. ajeti i dhënies sadaka para takimit me Muhamedin a.s.:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَاجَيْتُمُ الرَّسُولَ فَقَدِّمُوا بَيْنَ يَدَيْ نَجْوَاكُمْ
صَدَقَةٌ ۚ ذَلِكَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَأَطْهَرُ ۚ فَإِنْ لَّمْ تَجِدُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ

“O ju që keni besuar, kur dëshironi të bisedoni me të dërguarin, jepeni një sadaka para bisedës suaj. Kjo është për ju më e pastër; e nëse nuk keni çka të jepni, All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (El-Muxhadele : 12)

me ajetin që pason:

أَشْفَقْتُمْ أَنْ تُقَدِّمُوا بَيْنَ يَدَيْ نَحْوَاكُمْ صَدَقَاتٍ ۚ فَإِذْ لَمْ تَفْعَلُوا وَتَابَ اللَّهُ
عَلَيْكُمْ فَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ ۚ وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا
تَعْمَلُونَ

“A u frikësuar (varfërisë) të jepni lëmoshë në prag të bisedës suaj? E kur ju nuk e bëtë dhe All-llahu ju fali, atëherë pra, faleni namazin, jepeni zekatin, respektojeni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, All-llahu është i njohur me punën tuaj.” (El-Muxhadele : 13)

c. Ajeti i idetit për një vit për gruan së cilës i vdes burri:

وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا وَصِيَّةً لَّأَزْوَاجِهِمْ مَّتَاعًا إِلَى الْحَوْلِ
غَيْرَ إِخْرَاجٍ

“Ata që vdesin nga mesi i juaj dhe lënë pas vete gra, le të testamentojnë (lënë porosi) për gratë e tyre, furnizimin për një vjet, duke mos i nxjerrë prej shtëpisë...” (El-Bekare : 240)
është shfuqizuar me ajetin:

وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ
وَعَشْرًا ۚ

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë.” (El-Bekare : 234)
dhe ideti u shndërrua në katër muaj e dhjetë ditë, pasi që në fillim kishte qenë një vit.

Mendimi i Ebu Muslimit

Ebu Muslim el Esfehaniu, mendimin e tij se nuk ka ndodhë shfuqizimi e argumenton me atë se në esencë Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësuar Kur'anin si në vijim:

لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ ۖ تَنْزِيلٌ مِّنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ

“Atij nuk mund t’i vishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të lavdishmit.” (Fussilet : 42)

Andaj po të shfuqizohej një pjesë e Kur’nit do të zhvlerësohej apo do të ishte i pavlefshëm.

Replikë – siç u sqarua më herët se shfuqizimi do të ishte pavlefshmëri, mirëpo këtu nuk kemi pavlefshmëri, se e pavlefshmja është e kundërta e së vlefshmes. Shfuqizimi është realitet dhe sinjeralitet dhe se përemri kthehet te tërësia e Kur’anit dhe të gjithë janë pajtuar se nuk shfuqizohet tërësia e Kur’anit ose që me ajetin, qëllimi ishte, këtij libri nuk i ka parapri diçka që e zhvlerëson dhe nuk do të vijë diçka në të ardhmen që do ta zhvlerësonte. Disa ekspertë të usulit mendimin (thënien) e Ebu Muslimit e interpretojnë kështu: ligji vazhdon të jetë në fuqi dhe nuk është tërhequr, por kuptimi është se përfundon me tekstin i cili tregon për përfundimin e tij dhe nuk është shfuqizim, por në realitet Ebu Muslim el Esfehaniu nuk e ka mohuar shfuqizimin.

Ebu Muslim el Esfehaniu dhe të tjerët i kundërshtojnë mendimet e shumicës absolute të dijetarëve. Sa i përket ajetit të testamentit, se është ajet i fuqishëm dhe vepohet me të, ashtu që testamentlënësi specifikon në cilësinë e jotrashëgimtarëve për shkak të pengesës së trashëgimisë, si f.v., për shkak të ndryshimit fetarë, kështu që nuk ka kundërthënie apo kundërshtim në mes të ajetit të testamentit dhe ajetit të trashëgimisë.

Replikohet me atë se ligji i obligueshmërisë së testamentit është shfuqizuar me ajetin e trashëgimisë, ose me hadithin mutevatir **“Trashëgimtarit nuk i lihet testament.”**³⁴ andaj nuk është pengesë që të jetë e pëlqyeshme t’i lihet testament jotrashëgimtarit.

Ndërsa, ajeti i qëndrueshmërisë përballë armikut, ajeti i parë është ligji i vendosmërisë, ajeti i dytë është specifikuar me ligjin për lehtësim dhe askush nuk ka thënë se ligji për lehtësim e shfuqizon ligjin vendosës. Ajeti i tejumumit nuk e ka shfuqizuar ajetin e abdesit.

Është kundërpërgjigjur me atë se, shfuqizimi i qëndrueshmërisë përballë dhjetë personave është bërë vetëm për shkak të dobësisë para armikut.

Ajeti i dhënies sadaka para takimit me Muhamedin a.s. është tërhequr për shkak të mosekzistimit të mëtejme të arsyes së ligjit, e arsyeja ka qenë për të dalluar hipokritin ndaj të tjerëve, ndërsa zhdukja e arsyes për arsyeshmëri të ligjit nuk quhet shfuqizim, siç e kemi sqaruar më parë.

Replikohet me atë se, arsyeja e ligjit nuk është për të dalluar hipokritin prej të tjerëve, sepse kjo do të nënkuptonte që ai i cili nuk ka dhënë sadaka (para takimit me Muhamedin a.s.) është hipokrit, ndërsa askush tjetër përpos Aliut r.a. nuk ka dhënë sadaka, andaj a do të thotë kjo se të tjerët janë jobesimtarë?!

Ajeti i idetit njëvjeçar të asaj së cilës i vdes burri. Ajo qëndron një vit nëse është shtatzënë dhe kjo nuk do të thotë shfuqizim, por është i llojit të specifikimit.

Replikë – iddeti, në esencë është i papërdorshëm sepse ai idet është ideti i shtatzënisë dhe jo ideti njëvjeçar (vjetorë). Argument i kësaj është se gruaja nëse lind para një viti, e përfundon idetin e saj, nëse shtatzënia zgjat më shumë se një vit, nuk përfundon ideti deri sa të lind.

Sipas mendimit tim, mospajtimi në mes të shumicës absolute të dijetarëve dhe Esfehaniut nuk është i thellë sepse shumica absolute e dijetarëve, e shohin tërheqjen konkrete të ligjit, ndërsa Esfehaniu, ligjin e shfuqizuar apo tërheqjen e tij e interpreton me ndodhjen në rast se nuk paraqitet për të ligji shfuqizues. Kjo kuptohet instiktivisht. Argument për këtë është rregulli “Bazike e çështjeve është lejimi.” Kjo është e njohur se pranohet edhe te shumica absolute e dijetarëve, posaçërisht kur dihet se ai logjikisht nuk e mohon lejimin e shfuqizimit.

E dyta: Shfuqizimi i sunetit me sunet

Dijetarët e usulit janë pajtuar në lejimin e shfuqizimit të sunetit me sunet. Suneti mutevatir me sunetin mutevatir; suneti mutevatir me sunetin meshhurë; te Hanefijtë lejohet shfuqizimi i informatës së vetme me hadithin mutevatir dhe me transmetim të vetëm.

Argument për këtë kemi transmetimet e mëparshme të shfuqizimit të vizitës së varreve dhe shfuqizimi i konservimit të mishit të kurbanave, kur pejgamberi s.a.v.s. e ka lejuar vizitën e varreve.

Për vizitën e varreve ka thënë: **“Ua kam ndaluar vizitën e varreve, ndërsa tani vizitoni.”**

E ka lejuar konservimin e mishit kur ka thënë: **“Unë vërtetë u kam pas ndaluar konservimin për shkak të vonesës së karvanëve, ndërsa tani konservoni.”**

Transmetohet se Muhamedi a.s. për alkoolistin ka thënë: **“Nëse pi për të katërtën herë, dënojeni me ekzekutim.”** Mirëpo është shfuqizuar me transmetimin tjetër të Muhamedit a.s.: **“Nëse vërtetohet se ka pirë alkool për të katërtën herë, mos e ekzekutoni.”**³⁵

Sa i përket shfuqizimit të hadithit mutevatir me transmetimin e vetëm, kjo është e lejuar, mirëpo te një pjesë e madhe e dijetarëve thuhet se nuk ka ndodhur ndërsa dhahirijtë e vërtetojnë.³⁶

Pjesa e madhe e dijetarëve argumentohen me atë se transmetimi i vetëm është i dobët, ndërsa hadithi mutevatir më i fortë se ai, ndërsa më e fuqishmja nuk shfuqizohet me më të dobëtën dhe se e dyshimta nuk e shfuqizon të sigurtën, siç transmetohet prej sehabëve, si f.v., thënia e Umerit r.a.: *“Nuk e anashkalojmë librin e Zotit tonë dhe as sunetin e pejgamberit tonë për shkak të thënies së një gruaje, për të cilën nuk e dimë se a e flet të vërtetën apo gënjen, e ka mbajtur mend apo ka harruar.”*³⁷

Po ashtu edhe thënia e Aliut r.a.: *“Nuk e anashkalojmë librin e Zotit tonë dhe as sunetin e pejgamberit tonë me thënien e një beduini.”*³⁸

Këto dy sehabë nuk e kanë pranuar transmetimin e vetëm dhe nuk e kanë anashkaluar Kur'anin por kanë gjykuar me Kur'an, madje nuk e kanë anashkaluar as hadithin mutevatir për shkak të transmetimit të vetëm.

Dhahirijtë janë argumentuar me atë të obligueshmërisë së kthimit në drejtim të Mesxhidi Aksasë. Dihet se drejtimi në namaz në drejtim të Mesxhidi Aksasë ka qenë me hadithin mutevatir sepse nuk kemi ajet në Kur'an i cili tregon për të, dhe përderisa banorët e Kubasë faleshin në

drejtim të Mesxhidi Aksasë duke u bazuar në hadithin mutevatir, atyre deri sa ishin në namaz u shkon një njeri dhe i tregon si i deleguar i pejgamberit s.a.v.s., duke u thënë: *Kibla është ndërruar në drejtim të Qabesë dhe ata duke qenë në namaz janë kthyer në drejtim të Kiblës, duke e pranuar transmetimin e vetëm si shfuqizim ndaj hadithit mutevatir.*

Pejgamberi s.a.v.s. e dërgonte një të dërguar për t'i raportuar ligjet, e prej atyre ligjeve, ka pasur ligj të fuqizuar dhe ligj shfuqizues.

Është shfuqizuar thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعُمُهُ إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً

“Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej diçka të ndaluar prej ushqimeve përpos nëse është cofëtinë.” (El-Enam : 145)

Me transmetimin e vetëm është edhe ajo se Muhamedi a.s. e ka ndaluar ngrënien e mishit të kafshëve me kthetra dhe sqepshqyes dhe mishngrënës³⁹ dhe kështoj përderisa Kur'ani shfuqizohet me transmetimin e vetëm, atëherë lejohet të shfuqizohet edhe hadithi mutevatir (me transmetimin e vetëm).

Replikë – rasti (ngjarja) i banorëve të Kubasë është prej transmetimeve të transmetimit të vetëm ose i bashkëngjitet fakti i cili siguron njohuri të sigurt si f.v., afërsia me xhaminë e të dërguarit dhe pejgamberi s.a.v.s. i ka cilësuar si njerëz të përpiktë dhe afërsia e tyre ka ndikuar që të kthehen në drejtim të Mesxhidi Haramit, përderisa dërgimi i një raportuesi, lejohet që për lajm të jetë transmetues i vetëm dhe nëse nuk është i dërguar si raportues atëherë nuk lejohet dhe nuk është konfirmuar se pejgamberi s.a.v.s. ka dërguar që të shfuqizohen ligje të cilat janë ligjësuar me lajm të prerë.

Ajeti i ndalimit të cofëtinës e të ngjashme, të cilat janë të pakufishme për të ardhmen sepse thënia e Zotit të Lartmadhëruar “Nuk gjej.” është fjalë në kuptim të plotë i ndajfoljes së tashme dhe fjalisë i jepet ai kuptim, po të kishte qenë qëllimi i ajetit përkufizimi për të ardhmen, kjo nuk do të ishte shfuqizim sepse hadithi e tërheq ligjin e lejimit bazë të cilën e ka lejuar ajeti, ndërsa tërheqja e ligjit bazë nuk llogaritet shfuqizimi. Po ashtu edhe nëse ajeti përfshinë të ardhmen, hadithi është specifikues e jo shfuqizues.

E treta: Shfuqizimi i sunetit me Kur'an

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket specifikimit të sunetit me Kur'an:

- Shumica absolute e dijetarëve, e prej tyre dhahirijtë e lejojnë,
- Shafijjtë nuk e lejojnë.

Shumica absolute e pranojnë këtë lloj shfuqizimi dhe e argumentojnë si në vijim:

1. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde nga qielli, e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabja), që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes), dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni nga ajo anë.” (El-Bekare : 44)

Shfuqizim i ligjit i cili ka qenë i ligjësuar me sunet, pra falja në drejtim të Mesxhidi Aksasë

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

فَإِنْ عَلِمْتُمُوهُنَّ مُؤْمِنَاتٍ فَلَا تَرْجِعُوهُنَّ إِلَى الْكُفَّارِ

“Nëse vërtetoni se ato janë besimtare, atëherë, mos i ktheni ato te jobesimtarët.” (El-Mutmehine : 10)

Shfuqizim i cili sipas marrëveshjes së Hudejbijes në dhul kaëde të vitit 16 të hixhretit, ku sipas asaj marrëveshje Muhamedi a.s. duhej t'i kthente gratë te kurejshët.

2. Ajeti i ndalimit të alkoolit:

إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ

“Pa kurrfarë dyshimi, bastoret...” (El-Maide : 90)

është shfuqizuar lejimi i alkoolit.

Ajeti:

فَالآنَ بَاشِرُوهُنَّ

“Dhe tani kontaktoni me to.” (El-Bekare : 187)

është shfuqizuar ndalimi i kontaktimit gjatë natës së ramazanit.

Ajeti:

فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ

“Dhe kush prezanton në këtë muaj le të agjëroj.” (El-Bekare : 185)

është shfuqizuar dita e ashurasë, e këso raste të ngjashme ka shumë.

Shafijju deklaron se: Nuk lejohet shfuqizimi i sunetit me Kur'an. Në librin e tij “er-Risale” shkruan “Sunetin e të dërguarit të Allahut nuk e shfuqizon përpos suneti i të dërguarit të Allahut.” Nëse Zoti i Lartmadhëruar dëshiron të thotë diçka apo një çështje e cila nuk është çështje e të dërguarit të Allahut, do ta bënte që Allahu ta tregoj atë nëpërmjet të dërguarit të Tij, derisa t’ua sqaroj njerëzve se është shfuqizuar prej Allahut sepse ka qenë më parë, që të zëvendësoj më vonë atë çështje dhe kjo është e përmendur në sunetin e të dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Kjo është replikuar te shfuqizuesi, te rastet të cilat i kanë përmendur shumica absolute e dijetarëve se kjo bëhet edhe me sunetin sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لُتَّبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ

“Që t’u sqarohet njerëzve çka u është zbritur atyre.” (En-Nahl : 44)

E ka bërë sunetin sqarues dhe nëse shfuqizon suneti atëherë do të dilte jashtë kornizave të sqarimit dhe kjo nuk është e lejuar.

Replikë – me fjalën “sqarim” qëllimi është *kumtimi*, pa marrë parasysh kumtimin e Kur’anit apo diçka tjetër, mirëpo arsyetimet të cilat i thotë Shafijju mund t’i kundërshtojmë si në vijim.

Frika e tij (Shafijut), se mund të ndodh anashkalimi i sunetit, me pretendimin se e ka kundërshtuar Kur’anin e cila mund të ndikon negativisht në mendje dhe pastaj mund të largohen njerëzit nga veprimi me sunet, se mos ndoshta e ka shfuqizuar Kur’anin dhe patjetër duhet shfuqizuar me sunet tjetër.

Nga kjo shihet qartë se, mospajtimi i Shafijut me shumicën absolute të dijetarëve nuk rezulton ndonjë rezultat praktik, sepse të gjithë pajtohen në atë se ligjet mbeten të përgjithmonshme dhe në tërheqjen e ligjeve nga skena, por mospajtimi qëndron në argumentin shfuqizues.

E katërta: Shfuqizimi i Kur'anit me sunet

Papajtueshmëria në këtë lloj shfuqizimi është sikurse te papajtueshmëria e mëhershme në mes të shumicës absolute të dijetarëve dhe Shafiijut.⁴¹

1. Shumica absolute e dijetarëve, prej tyre edhe Ibn Hazmi Dhahiriju, deklarojnë se, logjikisht nuk ka pengesë që disa pjesë të Kur'anit të shfuqizohen me sunet dhe kjo veçse ka ndodhur. Është shfuqizuar ajeti i testamentit të prindërve dhe familjarëve me hadithin e Muhamedit s.a.v.s.: **“Nuk ka testament për trashëgimtarin.”** Është shfuqizuar ligjësimi i dënimit të prositucionit:

الرَّانِيَةُ وَالرَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ

“(Dispozitë obliguese është që) Laviren dhe lavirin t’i rrihni, secilit prej tyre me nga njëqind të rëna.” (En-Nurë : 2)

me gurëzimin e ligjësuar me sunet.

Vërehet se Hanefijtë e kanë lejuar shfuqizimin me sunetin mutevatir dhe meshhurë për shkak të vlerës së tyre tek njerëzit, ndërsa Ibn Hazmi e ka lejuar me transmetimin e vetëm.

Replikë e dy argumenteve – ajeti i obligueshmërisë së testamentit për prindërit dhe të afërmit nuk është shfuqizuar me ajetin e sipërpërmendur por është shfuqizuar me ajetet e trashëgimisë, siç është vërtetuar se Ibni Abasi ka thënë: Ajeti i testamentit është transmetuar me ajetet e trashëgimisë.

Te Shafiijtë ky është argument i pavlefshëm, vetëm poqëse thuhet: Mund të bëhet bashkimi i ajetit të testamentit dhe të bartet te jotrashëgimtarit dhe ajetit të trashëgimive si kategori e trashëgimtarëve.

Sa i përket gurëzimit me sunet, nëse nuk themi se është ligjësuar me ajetin: **“Të martuarin dhe të martuarën, nëse bëjnë prostitucion gurëzoni deri në vdekje...”** dhe kjo nuk është natyrë e shfuqizimit por është natyrë e specifikimit.

2. Shafiiju deklaron se nuk lejohet shfuqizimi i Kur'anit në sunet, qoftë edhe nëse janë hadithe mutevatir ose meshhurë dhe nuk shfuqizohet Kur’ani vetëm se me Kur’an dhe të ngjashme dhe është argumentuar me shumë argumente, prej tyre dy argumente si në vijim:

1. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

مَا نَنْسَخْ مِنْ آيَةٍ أَوْ نُنسِهَا نَأْتِ بِخَيْرٍ مِّنْهَا أَوْ مِثْلَهَا ۗ أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?” (El Bekare : 106)

Ajeti tregon se ai i cili shfuqizon është Allahu i Lartmadhëruar dhe kjo nëpërmjet Kur'anit. Kështu Kur'ani është shfuqizues i Kur'anit dhe jo suneti, po ashtu Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësuar që ligji shfuqizues është më i mirë se i shfuqizuari ose i ngjashëm me të dhe suneti nuk është më i mirë se Kur'ani dhe jo i ngjashëm me të dhe suneti nuk mund të jetë shfuqizues i Kur'anit.

Po ashtu ajeti sqaron specifikimin se për atë zëvendësim duhet ta bëjë ai i cili ka fuqi të plotë e ai është Allahu i Lartmadhëruar dhe shfuqizimi vjen vetëm prej Tij dhe shfuqizues është Kur'ani dhe jo suneti.

Replikë – suneti është prej Allahut sikurse Kur'ani, e kjo në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّ هُوَ إِلَّا وَحْيِي يُوحَىٰ

“Dhe nuk flet nga vetja, por është vetëm shpallje e cila shpallet.” (En-Nexhm : 4)

vetëm se Kur'ani është mrekulli e përgjithmonshme si lexim, ndërsa suneti nuk është ashtu.

Qëllimi me pjesën “më e mirë” ose “e ngjashme” është për ligjin varësisht prej dobisë ndaj njerëzve, gjë që tregon se ky ajet nuk tregon se Kur'ani nuk shfuqizohet me sunet.

2. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar për pejgamberin s.a.v.s.:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“Ty ta zbritëm Kur’anin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur’anin).” (En-Nahl : 44)

Çështja e sunetit është për të sqaruar Kur’anin dhe jo për ta shfuqizuar atë, këtë e përforcon edhe ajeti tjetër:

قُلْ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أُبَدِّلَهُ مِنْ تِلْقَاءِ نَفْسِي ۖ إِنِ اتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ

“Thuaj: Mua nuk më takon që ta ndryshojë vetë, unë përcjelli vetëm atë që më shpallet.” (Junus : 15)

Ndryshimi nuk është prej pejgamberit s.a.v.s. dhe jo për të shfuqizuar Kur’anin me sunet.

Replikë – shfuqizimi është lloj i sqarimit sepse sqaron skadimin e ligjit sheriatik me rrugën sheriatike të mëvonshme dhe pasi që suneti sqaron Kur’anin, nuk ka pengesë që ta sqarojë atë. Ndryshimi nuk bëhet nga vetvetja e pejgamberit s.a.v.s. Kur ndryshimi ndodhë prej sunetit, ai është shpallje prej Zotit të Lartmadhëruar.

Për mendimin tim, atë që Shafijitë e shohin si shfuqizim, Hanefijitë e shohin si specifikim, atëherë mospajtimi është vetëm nga aspekti i përcaktimit.

Megjithëkëtë mendimi i shumicës absolute të dijetarëve është më prioritarë, e ai është se suneti është prej Allahut të Lartmadhëruar sikurse Kur’ani që është Ligj i Zotit të Lartmadhëruar, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا

“Çka t’ju jep Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbajuni.” (El-Hashr : 7)

Gjë që tregon se suneti nga pejgamberi s.a.v.s. vërtetohet si mutevatir ashtu sikurse Kur’ani. Dispozita e tij është si dispozitë e Kur’anit për shfuqizim dhe për shfuqizimin e ligjeve tjera. Dhe nuk ka as argument logjik dhe as sheriatik i cili e pengon këtë.

Nga kjo sqarohet se shfuqizimi e Kur’anit me sunet dhe shfuqizimin e sunetit me Kur’an e kanë lejuar shumica absolute e dijetarëve, ndërsa Shafijiu nuk e pranon, duke thënë: **“Libri i Allahut shfuqizohet vetëm me librin e Allahut dhe suneti shfuqizohet me sunet.”** dhe kuptimi i kësaj

është se: Kur të shfuqizohet Kur'anit me sunet, patjetër duhet të ketë mbështetje prej Kur'anit pas kësaj e cila tregon përputhshmërinë e shfuqizimit dhe të sunetit të atij ligji dhe atëherë do të ishte mbështetës i tij dhe kur suneti shfuqizohet me Kur'an, patjetër që duhet ta tregoj peygamberi s.a.v.s. ashtu që të harmonizohet shfuqizimi i Kur'anit për atë ligj dhe të jetë mbështetës i atij shfuqizimi.⁴²

E pesta: Shfuqizimi i argumenteve jotekstuale

Dijetarët kanë hulumtuar mundësinë e ndodhjes së shfuqizimit të argumenteve jotekstuale siç janë: ixhmai, kijasi ose parimi i interesit.

1. Shfuqizimi i ixhmail.

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë se ixhmai nuk shfuqizon as nuk shfuqizohet, që do të thotë se nuk mund të jetë shfuqizues as i shfuqizuar.⁴³

Sa i përket asaj se nuk mund të jetë i shfuqizuar. Shfuqizuesi është teksti ose ixhmai ose kijasi.

Sa i përket tekstit, nuk mund të jetë shfuqizues sepse ixhmai themelohet vetëm pas vdekjes së Muhamedit a.s. dhe shfuqizimi nuk mund të bëhet pas vdekjes së tij dhe nuk mund ta shfuqizoj teksti sepse të gjitha tekstet ndërlidhen prej Muhamedit a.s.

Ixhmai nuk mund ta shfuqizoj ixhmain tjetër sepse kur të themelohet ixhmai, bëhet obligim që të veprohet me të dhe nuk është e drejtë të kundërshtohet, dhe ligji për të cilin dakordohen bëhet ligj i prerë dhe kur të themelohet ixhmai tjetër pas tij, nuk llogaritet dhe nuk veprohet me të sepse po të themelohej ixhmai i ri, atëherë njëri prej tyre është gabim, e ixhmai nuk mund të jetë gabim sepse është konfirmuar se umeti nuk mund të pajtohet për një çështje të gabuar.

Sa i përket Kijasit, nuk lejohet të shfuqizohet ixhmai me të sepse kusht i kijasit është që të mos jetë në kundërshtim me ixhmain dhe për shkak se kijasi është jo i prerë nuk mund ta shfuqizoj ixhmain e sigurt.

Disa dijetarë të usulit e kanë lejuar të shfuqizohet ixhmai me ixhmaë të ngjashëm sepse është ixhmaë i prerë dhe nuk mund të jetë gabim dhe nëse

realizohet një gjë e tillë, atëherë vjen argumenti i prerë i cili e shfuqizon atë, sikurse teksti i prerë që e shfuqizon tekstin e prerë.⁴⁴

Replikë – ixhmai i parë është i kushtëzuar që të mos themelohet ixhmaë tjetër për atë çështje.

Ixhmai i bazuar në parimin e interesit.

Edhe pse mendimi prioritarë është mendimi i shumicës absolute të dijetarëve, se nuk shfuqizohet ixhmai, duhet thënë se ixhmai i themeluar për interes lejohet të shfuqizohet me ixhmain e mëvonshëm, nëse ndryshon ai interes për të cilën është themeluar ixhmai i mëparshëm, sepse argumenti i ixhmainit është formuar për të mbetur ai interes dhe kur interesi ndryshon nuk ka arsye që të vazhdoj ixhmai më tutje.⁴⁵

Ixhmai nuk mund të jetë shfuqizues

Sa i përket asaj se ixhmai nuk mund të shfuqizoj argumentin tjetër. E shfuqizuara duhet të jetë ose tekst ose ixhmaë ose kijasë. Sa i përket tekstit, nuk mund të shfuqizohet me ixhmaë, sepse nuk mund të themelohet ixhmai në kundërshtim me tekstin sepse duhet të mbështetet në të. Nëse gjendet një bazë e tekstit tjetër, në të cilën nuk mbështetet ixhmai, atëherë ajo bazë juridike është shfuqizues dhe jo ixhmai.

Sa i përket asaj se ixhmai nuk shfuqizon ixhmain tjetër, për shkak të kontrastit të dy ixhmave, nuk lejohet të themelohet ixhmai në kundërshtim me ixhmain tjetër, siç e sqaruam në rastet e mëparshme.

Sa i përket kijasit, kijasi nuk mund të shfuqizohet me ixhmaë sepse prej kushteve për të vepruar me kijasë është që të mos ketë ixhmaë në kundërshtim me të dhe nëse gjendet ai ixhmaë, nuk veprohet me kijasë për shkak të mosplotësimit të kushtit të tij.

Dhahirijtë, e po ashtu edhe disa profesorë të Hanefijve dhe Hanbelijve, disa muëtezilë dhe Isa bin Ebani, deklarojnë se lejohet shfuqizimi me ixhmaë, por jo me vet ixhmain por me mbështetjen e themelimit të tij prej teksteve. Këta janë argumentuar me tre argumente.

E para: Abasi i ka thënë Uthman bin Afanit r.a.: “Si mund të mbulohet nëna, nga një e treta në një të gjashtën për shkak të vëllezërve. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَإِنْ كَانَ لَهُ إِخْوَةٌ فَلِأُمِّهِ السُّدُسُ

**“Dhe nëse i vdekuri ka vëllezër, atëherë nënës i takon një e gjashta.”
(En-Nisa : 11)**

Ndërsa dy vëllezër nuk janë vëllezër (shumës).”

Uthmani r.a. thotë: “O djalosh, është mbuluar nga mendimi i popullit tënd.”

Që do të thotë se me vendim të ixhmait të sehabeve është mbuluar nëna nga një e treta për shkak të dy vëllezërve (jo shumë vëllezërve). Kështu i bie se ixhmai e ka shfuqizuar ajetin.

Replikë – shumësi është i papërcaktuar “vëllezër”. Për ajetin ka mospajtime rreth minimumit të cilin e thonë gjuhëtarët, se duhet të jetë dy vëllezër apo tre vëllezër, dhe ixhmai është për njërën prej dy interpretimeve të ajetit dhe numri dy është në kuptim alegorik dhe kështu fjala “vëllezër” ka për qëllim “shumësin” e vëllezërve dhe nuk është shfuqizim i ajetit.

E dyta – ixhmai i sehabeve për në kohën e Umerit r.a. për moszbatimin e kategorisë së përfitimit të zemrave.

Replikë – rënia e kategorisë së përfitimit të zemrave, nuk është pranuar prej të gjithë muxhtehidëve dhe nuk është vërtetuar themelimi i ixhmait për këtë çështje.

E treta – argumenti i ixhmait është prej argumenteve të sheriatit sikurse Kur’ani dhe suneti dhe për këtë arsye lejohet shfuqizimi me të, ashtu sikurse lejohet specifikimi me të.

Replikë – ixhmai nuk është i themeluar për të kundërshtuar Kur’anin dhe sunetin, për këtë arsye nuk mund të paramendohet si shfuqizues i tyre.

Ka dallim në mes të shfuqizimit dhe të specifikimit, sepse e para e tërheq ligjin në tërësi, ndërsa e dyta (specifikimi) e përkufizon ligjin në disa njësi të tij dhe nuk ka pengesë që specifikimi të bëhet prej ixhmait, ndërsa e kundërta është te shfuqizimi sepse ekziston pengesa që nuk e lejon që ixhmai të jetë shfuqizues, e ajo pengesë është kushtëzimi që të mos bie ndesh me tekstin i cili ekziston para saj.

Shfuqizimi i kijasit

Shumica absolute e dijetarëve, prej tyre dhahirijtë dhe shumica e Shafiijve, deklarojnë se kijasi nuk mund të jetë as shfuqizues dhe as i shfuqizuar, dhe kjo pas vdekjes së pejgamberit s.a.v.s. Ndërsa sa i përket gjatë jetës së tij, pra gjatë jetës së pejgamberit s.a.v.s. lejohet që natyra e kijasit të jetë shfuqizues dhe i shfuqizuar, sepse nëse shfuqizohet në jetën e pejgamberit s.a.v.s. ai është shfuqizuar me tekstin e konfirmuar prej shpalljes, i bazuar me skadimin e datës së të vepruarit me kijasë. Nuk lejohet shfuqizimi i kijasit pas vdekjes së pejgamberit s.a.v.s., nuk bëhet shfuqizimi i një kiasi me kijasë tjetër, por është argument për muxhtehidin i cili arrin deri aty (te kiasi) me mendimin e tij dhe me ixhtihadin e tij.

Nëse kundërshtohen dy analogji (kijase) prej muxhtehidëve, nuk realizohet asnjëri prej tyre, derisa të shfuqizohet njëri prej tjetrit ose anasjelltas.

Nëse burojnë që të dyja nga i njëjti muxhtehidë, atëherë kijasi i dytë është në kundërshtim me kijasën e parë dhe jo shfuqizues i tij dhe jo prioritetdhënie e njërës ndaj tjetrës, si f.v., favorizimi në mes të kijasit dhe istihsanit të parë, si kijasi me arsyen e parë të qartë dhe kijasi me arsyen jo të qartë.

Nuk lejohet që kijasi të kundërshtojë tekstin ose ixhmain, ashtu që të jetë shfuqizues i tyre sepse kushti i kijasit është që të mos bie ndesh me tekstin ose ixhmain, ashtu siç nuk lejohet që kijasi të shfuqizojë tekstin ose ixhmain sepse kjo do të ishte gabim.

Përfundim – Shumica absolute e dijetarëve thonë se kijasi nuk mund të jetë shfuqizues sepse dijetarët nuk kanë autorizim që t'i zhvlerësojnë ligjet.

Nuk ka hapësirë *ideja e ixhtihadit* në këto çështje dhe nuk mund të jetë e shfuqizuar sepse kusht është që për të vepruar duhet në rend të parë që njërit kijasë t'i jepet prioritet dhe është arritur dhënia përparësi pas kundërshtimit mes veti dhe nuk është i konceptit të shfuqizimit i cili është tërheqja e ligjit.

Në librin “**Xhemul-Xhevamiu**” Sebekiju thotë: “E vërteta është se lejohet shfuqizimi i tekstit me kijasë, për shkak se mbështetjen e ka në tekst dhe i bie sikurse teksti është shfuqizues.”⁴⁶

Amediu, dijetar Shafii, deklaron se: Lejohet që si lloj, kijasi të jetë i shfuqizuar nëse arsyeshmëria e tij ka qenë i tekstit sepse atëherë e ka kuptimin e tekstit dhe mundet që teksti i ligjit të tij të shfuqizohet me tekst ose në kuptim të kijasit, ndërsa nuk lejohet të shfuqizohet nëse arsyeshmëria

është prodhim sipas këndvështrimit të muxhtehtidit sepse ligjit të kijasit nuk i mbetet të veprohet në ligj sekondar, për shkak se ekziston çështje e cila e kundërshton, e atëherë zhvlerësohet, mirëpo kjo nuk quhet shfuqizim sepse ligji i aprovuar me kijasë është prodhim i arsyes e cila nuk është aprovuar nga ligjërimi i Ligjvënësit sepse shfuqizimi është tërheqja e ligjit të aprovuar nga ligjërimi i Ligjvënësit.

Amediu, sa i përket llojit të kijasit si shfuqizues, i ka sjellë tri mendime:

E para: Absolutisht nuk lejohet, që do të thotë se nuk mund të jetë shfuqizues.

E dyta: Absolutisht lejohet, që do të thotë lejohet të jetë shfuqizues.

E treta: Mes i dy mendimeve të mëparshme, nëse kijasi është i qartë mund të jetë shfuqizues, nëse kijasi është i fshehtë nuk mund të jetë shfuqizues.

Amediu e favorizon mendimin i cili thotë se, nëse arsyeshmëria është e tekstit, atëherë kijasi e ka konceptin e tekstit dhe lejohet që kijasi të jetë shfuqizues i tekstit ose të kijasit tjetër. Ndërsa nëse arsyeshmëria është i prodhuar, kijasi nuk mund të shfuqizoj sepse ligji i kijasit është i aprovuar prej kijasit me arsyeshmëri të prodhuar dhe jo prej ligjëritimit të Ligjvënësit. Shfuqizuesi patjetër duhet të jetë nëpërmjet rrugës së shariatit.

Përfundim: Amediu e favorizon mendimin e atyre që thonë: Kijasi është shfuqizues dhe i shfuqizuar, nëse arsyeja është prej tekstit.

Nuk lejohet as të jetë shfuqizues dhe as i shfuqizuar nëse arsyeshmëria është e prodhuar sepse nuk është ligj i aprovuar nga Ligjvënësi, sikurse edhe nuk veprohet me kijasë nëse paraqitet çështje e cila e kundërshton dhe kjo nuk quhet shfuqizim.

Tema e pestë: Format e shfuqizimit dhe mënyrat e tij

Format e shfuqizimit apo mënyrat e tij mund t'i njohim në nëntë çështje e ato janë:

1. Shfuqizimi i leximit dhe i ligjit së bashku;
2. Shfuqizimi i ligjit dhe jo i leximit;
3. Shfuqizimi i leximit dhe jo i ligjit;
4. Shfuqizimi nëpërmjet rrugës së aneksit në tekst;
5. Shfuqizimi nëpërmjet pakësimit;
6. Shfuqizimi i të thanurës dhe jo i të kuptuarës;
7. Shfuqizimi i lajmeve;
8. Shfuqizimi i thënies dhe veprës në sunet;
9. Shfuqizimi i ligjit bazë të analoguar patjetëron shfuqizimin e degës analoguese.

E para: Shfuqizimi i ligjit dhe leximit së bashku

Amediu thotë: Dijetarët janë dakorduar në lejimin e shfuqizimit të leximit dhe jo të ligjit dhe të kundërtën dhe shfuqizimi i tyre së bashku. E kanë kundërshtuar vetëm mu'etizilët,⁴⁷ i cili llogaritet mendim i izoluar.

Argument i shfuqizimit të leximit dhe ligjit së bashku është shfuqizimi i fletushkave të Ibrahimit dhe të pejgamberëve tjerë të mëparshëm. Ata kanë zbritur, janë lexuar dhe është vepruar me to.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٨﴾ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٩﴾

“Vërtet kjo ishte në broshurat e lashta: në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait.” (El-Eala : 18, 19)

أَوَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ آيَةٌ أَنْ يَعْلَمَهُ عُلَمَاءُ بَنِي إِسْرَائِيلَ

“A nuk ishte për ata (për jobesimtarët mekas) argument, se atë e dinin dijetarët (ulemaja) e beni israilëve?”

Pastaj, nuk na ka mbetur asgjë neve, as në të lexuar dhe as në të vepruar, gjë që tregon se është shfuqizuar edhe në të lexuar edhe si ligj.

Është konfirmuar në “Sahihë” se Aishja r.a. ka thënë: “Më parë ka zbritur se është e ndaluar dhjetë gjidhënie të plota, pastaj janë shfuqizuar pesë gjidhënie, pastaj ka vdekur i dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe nuk janë lexuar në Kur’an.”⁴⁸

Bejhekiu thotë: **“Dhjetë”** janë shfuqizuar edhe në të shkruar edhe si ligj, ndërsa pesë janë shfuqizuar në të shkruar dhe kanë mbetur pesë si ligj. Argument për këtë është se sehabet kur e kanë tubuar Kur’anin nuk e kanë lënë që të shkruhet, ndërsa kanë gjykuar për me pesë gjidhënie.⁴⁹

E dyta: Shfuqizimi i ligjit dhe i joleximit

Lejohet shfuqizimi i ligjit të ajetit dhe i joleximit, si f.v., afati i pritjes së gruas një vit të plotë dhe është shfuqizuar ligji i ajetit.

Është shfuqizuar ligji i testamentit të familjarëve dhe prindërve, ndërsa ajeti vazhdon të lexohet.

Është shfuqizuar ligji i ajetit të: **“Izolimi i gruas në shtëpi, nënçmimi i burrit shprehimisht në ndëshkim të prostitucionit.”**

Është shfuqizuar ligji i ajetit: dhënien e sadakasë para takimit me të dërguarin e Allahut s.a.v.s.⁵⁰

Ky është mendim i shumicës absolute të dijetarëve. Disa muëtezil e kanë ndaluar duke u argumentuar si në vijim: Sistemi i fjalëve dhe i kuptimit të tyre janë të pandashme, nuk lejohet tërheqja e njërës dhe mbetja e tjetrës, që do të thotë se, qëllimi prej tekstit është ligji i ndërlidhur me kuptimin e saj, teksti është mjet për të arritur te qëllimi dhe nuk ka tekst pa ligjin e tij. Ligji nuk mund të ligjësohet pa tekst dhe nuk mbetet pa të, si f.v. pronësia e blerësit realizohet me blerje dhe nuk ka pronësi pa blerjen, nëse prishet kontrata e shitblerjes.

Replikë: Kjo patjetërsueshmëri është e pranuar në fillim dhe jo në vazhdim. Në këtë rast fjala është për vazhdimin.

Mbetja e leximit dhe jo i ligjit, paramendohet mbetja e ligjit dhe i ngarkuari mbetet në injorancë.

Replikë: Mbetja në injorancë vjen në pyetje nëse nuk ka argument të shfuqizimit. Kur të qëndron argumenti nuk ka vend për injorancë.

Vlera e leximit të Kur'anit është në tregueshmërinë e ligjit sheriatik dhe i mohohet kjo vlerë nëse mbetet vetëm shprehja pa e treguar ligjin.

Replikë: Përkufizimi i vlerës në tregueshmërinë e mbetjes së ligjit është i papranueshëm. Prej vlerës është edhe mbetja e leximit për të ditur historinë e ligjësimit dhe për mrekullinë e sistemit të shfuqizimit sikurse edhe ajetet tjera të Kur'anit.

E treta: Shfuqizimi i leximit dhe jo i ligjit

Ky shfuqizim ka ndodhur, siç është rasti me thënien e Umer bin Hatabit r.a. i cili ka thënë: “Ka pas zbritur: I martuari dhe e martuara, nëse bëjnë prostitucion, gurëzoni deri në fund (të jetës së tyre), ndëshkim prej Allahut.” Është vërtetuar në hadithë: “Ky tekst ka qenë pjesë e Kur'anit, i cili lexohej, pastaj është shfuqizuar leximi i tij dhe ka mbetur ligji.”

Hanefijtë shtojnë edhe shembuj tjerë të leximeve të vetmuara, e ato janë: agjërimi i kompensimit tri ditë rresht, sipas leximit të Ibn Mes'udit (dhe agjërimi për të tri ditë rresht). Ky lexim ka qenë i njohur në kohën e Ebu Hanifes, mirëpo nuk është hasur se është transmetuar në nivel shumë të gjerë – mutevatir – i cili konfirmohet e ngjashme me Kur'anin.

Leximi i Ibni Abasit **“dhe mos agjëro, por plotësoji po aq ditë më vonë.”**

Leximi i Sead bin Vekasit: **“Dhe ai (i vdekuri) ka vëlla ose motër prej nëne, secilit prej tyre një e gjashta.”**

Ky është mendim i shumicës absolute të dijetarëve, ndërsa nuk e lejojnë muëtezilët, sikurse te lloji i dytë. Për këtë lloj të shfuqizimit komenton Hudarij, kur thotë:⁵¹ “Unë nuk e kuptoj konceptin e ajetit, Allahu e zbrit për të ligjësuar ligj, pastaj e tërheq leximin për të mbetur ligji i tij sepse Kur'ani ka për objektiv të tregoj ligjin dhe të jetë mrekulli në sistemin organizativ të tij dhe cili do të ishte interesi në tërheqjen e ajetit prej ligjit dhe në mbetjen e ligjit. Kjo është e pakuptueshme dhe nuk ka çka të mbështetet ai mendim.”

E katërta: Shfuqizimi nëpërmjet aneksit në tekst

Dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket shfuqizimit nëpërmjet aneksit në tekst, se a është shfuqizim apo jo?

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë se aneksi është specifikim dhe jo shfuqizim.

Hanefijtë e llogaritin se është shfuqizim.

Sfera e mospajtimit të njohur në mes të dijetarëve në lidhje me këtë çështje është aneksi i pavarur me ligjin e tekstit me të cilën bëhet aneksi dhe i cili rezulton më vonë nga aneksi ashtu që të mund të shfuqizohet, si f.v., kushtëzimi i nijetit në pastërti duke u bazuar në hadithin: **“Vërtetë veprat shpërblehen sipas qëllimit.”**, si aneks i ajetit të abdesit dhe aneksi i internimit pas shkopimit të dënimit të prostitutit me hadithin e Ibadetu bin Samet: **“Beqari dhe beqaresha shkopohen dhe internohen një vit.”**, pra ky është aneks i ajetit *shkopimi i prostitutit* dhe është si f.v., kushtëzimit të pastërtisë gjatë tavafit, në bazë të thënies së pejgamberit s.a.v.s.: **Tavafi në Qabe është namaz**⁵² dhe përcaktimi i lirimit të një robi për prishje të betimit, e cila kërkohet të lirohet në kompensimin e “Dhiharit” dhe të përбетimit, i cili është shtesë e tekstit të papërcaktuar të Kur’anit duke e përcaktuar me këtë atribut **“Dhe le të lirojë një rob.” (En-Nisa : 92)**

Dijetarët janë dakorduar se aneksi i tekstit nëse është adhurim i pavarur në vete, si f.v., aneksi i obligueshmërisë së agjërimit ose të zekatit, pas obligueshmërisë së agjërimit të zekatit, pas obligueshmërisë së namazeve nuk është shfuqizim i ligjit i cili aneksohet sepse ai është aneks i ligjit në ligjësim pa u ndryshuar e para dhe nuk është adhurim i llojit të parë.

Ajo çka raportohet prej disa dijetarëve të Irakut, se aneksi i cili është i llojit të anekseve, si f.v., aneksi i namazit të gjashtë, nga pesë kohët e namazit, është shfuqizim sepse ndryshe është namazi i gjashtë nga pesë namazet tjera me aprovimin e namazit të gjashtë.

Ky është gabim, i pavlefshëm dhe i paargumentuar, dhe nuk ka dyshim në këtë, sepse namazi i mesëm nuk ka për qëllim namaz i mesëm dhe i gjashti në numër, por qëllimi është vlera (e namazit të mesëm) dhe se atributi “i mesëm” ka kuptim të drejtë dhe jo kuptim ligjësimi dhe tërheqja e tij nuk është shfuqizim.

Edhe po të pranohet se qëllimi me të është i mesëm numëror, ky atribut nuk shfuqizohet sepse ajo veç është bërë faktik edhe nëse hiqet nga natyrshmëria e saj e mesme.

Përfundim – Janë pajtuar se aneksi i pavarur i adhurimit nuk është shtesë e adhurimit.

Papajftueshmëria qëndron nëse aneksi përkufizohet në shtesën në vet ligjin, si f.v., internimi pas ndëshkimit me shkopin dhe shtesa e një rekati apo sexhdeja ose shtesa e kushtit, si f.v., kushtëzimi i pastërtisë në tavaf, si f.v., kushtëzimi në përбетim në lirimin e një robi në kompensimin e përбетimit dhe “Dhiharit”, ose shtesa e atributit, si f.v., obligimi i zekatit në bagëti është arsyetuar me obligimin e zekatit të bagëtisë në kullosa, ku te shumica absolute e dijetarëve, prej tyre edhe te shumica e muëtezilëve është specifikim apo përcaktim dhe nuk është shfuqizim.

Te Hanefijtë kjo llogaritet si shfuqizim.⁵³ Nuk ka nevojë të tregoj mendimet e tjera gjerësisht sepse ato mendime nuk janë bosht i temës.

Paraqitet vlëra e këtij mospajtimi në ligjësimin e atij aneksi, se me çka nuk lejohet të shfuqizohet si f.v., a mund të shfuqizohet me informatën e vetme ose me kijasë.

Te Hanefijtë, të cilët atë aneksim e quajnë shfuqizim, aneksimi nuk mund të bëhet me informatën e vetme dhe as me kjasin sepse këto dyja nuk mund ta shfuqizojnë hadithin mutevatir dhe Kur’anin, për këtë arsye nuk e kushtëzojnë pastërtinë në Tavaf dhe as përбетimin në lirimin e rob-it, si f.v., kompensimin e DHIHARIT.

Shumica absolute e dijetarëve nuk e shohin se ai aneks është shfuqizim, ata deklarojnë se bëhet aneksimi me transmetimet e vetme me kijasë dhe me argumente tjera të cilat nuk janë të prera.

Efekt juridik i këtij mospajtimi është se shumica absolute e dijetarëve e ligjësojnë aneksin në Kur’an me informatën e vetme sepse ata nuk e llogaritin këtë shfuqizim, si në rastet të cilat i përmenda, si f.v., pasi në Kur’an ndalohet vëllai apo motra nga qumështi, Shafijjtë e parashohin që ai fëmijë të ketë pirë qumësht pesë herë. Po ashtu, te Shafijjtë kushtëzohet leximi i “Fatihasë” për vlefshmërinë e namazit, duke u mbështetur se në Kur’an është e paraparë të lexohet sa më lehtë prej Kur’anit.

Mirëpo Hanefijtë, duke pretenduar se nuk veprojnë me këtë rregull, nuk veprojnë me shumë informata të vetme, dhe në të gjitha veprimtaritë e tyre nuk shkojnë në këtë drejtim. Argument për këtë kemi se kushtëzojnë shumë kushte në veprimtaritë reciproke (muamelatë) të cilat kanë ardhur me hadithe dhe nuk i ka kushtëzuar Kur’ani, si f.v., deklarimi se shitblerja me

kusht është shitblerje e pavlefshme, duke vepruar me hadithin se ndalohej shitblerja me kusht.

Kjo favorizon mendimin se me përcaktimet të cilat burojnë nga hadithet e sakta, veprohet me ta dhe e papërcaktuara në Kur'an përcaktohet dhe nuk ka të bëjë me shfuqizim dhe kjo llogaritet sqarim i cili i bashkëngjitet tekstit të Kur'anit, sepse e papërcaktuara e Kur'anit ka qenë në vazhdimësi, mirëpo është tërhequr sepse detyrë e pejgamberit s.a.v.s. është që ta sqaroj atë.

Mirëpo Hudariju thotë: “Sa i përket aneksit siç është rasti me internimin pas ndëshkimit të prostitutit, quhet shfuqizim, sepse e tërheqë ligjin e përgjithshëm të buruar nga sheriat, e ai është ndalimi i persekutimit,⁵⁴ të cilin do ta sqarojmë më vonë.

Shkak pse Hanefijtë i kanë kundërshtuar shumë hadithe (transmetime) është se i kanë kundërshtuar të jenë aneks i Kur'anit, ndërsa aneksi është shfuqizim, dhe nuk e pranojnë shfuqizimin e Kur'anit me informatën e vetme. Në bazë të kësaj, nuk i pranojnë hadithet të cilat konkretizojnë leximin e fatihës në namaz dhe hadithet të cilat tregojnë për dëshmitarin dhe përbetimin, lirimin e robit dhe kushtëzimi i nijetit në abdes.

Sa i përket mes'hit të mesteve, është aneks i Kur'anit të pastrimit të këmbëve në abdes. Hanefijtë e llogaritin shfuqizim, sepse informatat e mes'hit mbi meste janë mutevatir edhe pse ato hadithe janë mutevatir kuptimor dhe jo tekstual.

Hanefijtë, mendimin e tyre e arsyetojnë me atë se aneksimi i ajetit është shfuqizim dhe teksti i shariatit i papërcaktuar obligon që ai tekst të veprohet si i papërcaktuar dhe nëse e përcaktojmë, e kemi shpërndarë në diçka tjetër sepse papërcaktimi dhe përcaktimi janë dy të kundërtat të cilat nuk mund të bashkohen dhe nëse e dyta është ndryshe nga e para, patjetër se thuhet ka skaduar e para dhe fillimi i së dytës, dhe ky është koncepti i shfuqizimit (sqarim i ligjit dhe fillimin e ligjit tjetër), që do të thotë se, ligji bazë ka qenë i lejuar edhe pa aneksimin, dhe kur është bërë aneksimi, është tërhequr për shkak të ligjit të ri dhe ky është shfuqizim dhe bëhet shfuqizimi i të papërcaktuarës tekstuale në vend të shfuqizimit të atij teksti.

Replikë – Baza e ligjit të parë ende është në fuqi, ndërsa hadithi apo kijasi janë sqarim dhe përcaktim i të papërcaktuarës, ose specifikim i të së përgjithshmes dhe jo shfuqizues i saj.

Argumentet e shumicës absolute të dijetarëve

Aneksi i kushtit, të atributit apo të një pjese, nuk e tërheq ligjin e sheriatit, dhe nuk quhet shfuqizim sepse shfuqizim është tërheqja e ligjit sheriatik.

Replikë – aneksi i atributit e tërheq ligjin sheriatik, siç është me rastin e thënies së pejgamberit s.a.v.s. **në bagëtinë e kullotave zekat.**⁵⁵ Me të kuptuarin e kundërt, fjala tregon se për të arsyetuarën nuk është obligim zekati. Po të bëhej obligim zekati në të me tekst të Kur'anit i cili urdhëron zekatin, atëherë ky hadith quhet tërheqës i ligjit të mëparshëm, i cili tregohet nëpërmjet të kuptuarit të kundërt. Te shumica absolute e dijetarëve e kuptuara llogaritet si argument.

Replikë – mohimi i zekatit nga arsyeshmëria e tij nuk është me të kuptuar, por me lejimin bazik të cilin e pranon logjika dhe tërheqja e ligjit nuk është shfuqizim.

Po ashtu, aneksi i kushtit mund të jetë tërheqje e ligjit sheriatik, si aneksi i pastërtisë në Tavaf dhe përbetimi me lirim të robit. Ky aneksim e ka tërhequr ligjin e lejimit të tavafit duke qenë i papastër, i cili rezulton nga papërcaktimi i ajetit:

وَلْيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ

“Dhe le të bëjnë tavaf Shtëpinë më të vjetër (Qaben).”

Është tërhequr lirimi i robit të pabesimtarit në kompensimin e dhiharit, i cili buron nga ajeti:

يُظَاهِرُونَ مِنْ نِسَائِهِمْ ثُمَّ يَعُودُونَ لِمَا قَالُوا فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ

“Ata që krahasojnë (me nëna) dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj zmbraresen nga ajo që kanë thënë, janë të obliguar që para se të kontaktojnë ndërmjet vete ta lirojnë një rob.” (El-Muxhadele : 3)

Të gjitha ligjet, si të lejimit ashtu edhe të dënimit, janë ligje të sheriatit.

Replikë – këto janë të llojit të përcaktimit të papërcaktuar dhe nuk janë shfuqizim.

Po ashtu, ndonjëherë shtesa e një pjese tërheq ligj sheriatik, si f.v., aneksi i internimit si ndëshkim i prostitutit. Ky aneks e tërheq ndalesën e cila gjenerohet nga thënia e pejgamberit s.a.v.s. nga thënia e pejgamberit

s.a.v.s.: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”** Nuk ka dyshim se ndalesa është ligj i sheriatit.

Replikë – aneksi i internimit pas shkopimit nuk llogaritet shfuqizim sepse mosinternimi ka qenë si ligj bazë dhe tërheqja e ligjit bazë nuk është shfuqizim.

E pesta: Paraqitja e mungesës në adhurim.

Dijetarët e usulit janë pajtuar se kur Ligjvënësi e pakëson një pjesë të adhurimit, ose e heq një kusht prej kushteve, si f.v., pakësimin e një rekati të namazit katër rekatësh ose heqjen e kushtit të pastërtisë, llogaritet shfuqizim, pasi i ka hequr ato sepse kanë qenë pjesë apo kusht, sepse kanë qenë obligim brenda ligjit të adhurimit, e pastaj është tërheq obligimi.

Mirëpo, a ka qenë kjo shfuqizim i bazës së adhurimit, pra pjesa tjetër pasi është tërheq ajo pjesë apo ai kusht?

Për këtë, dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme.

Shumica absolute e dijetarëve, e prej tyre edhe Shafiijtë, deklarojnë se nuk është shfuqizim i bazës së adhurimit.

Hanefijtë deklarojnë se është shfuqizim i adhurimit.

Autori i librit “Muslimu Thubut” (Ibn Abdu Shekur) e përkrah drejtimin e shumicës absolute edhe pse është dijetar Hanefijë, sikurse edhe një pjesë e madhe e mutekeliminëve e përkrahin mendimin se absolutisht quhet shfuqizim.

Gazaliu dhe Kadiu Abdul Xhebari bëjnë dallimin:

- Nëse aneks është kushti, shfuqizim nuk është shfuqizimi i adhurimit.
- Nëse aneksi është një pjesë, si f.v., qëndrimi në këmbë apo rukni i namazit, atëherë shfuqizimi është shfuqizim i adhurimit.

Kjo nga shkaku se kushti është pjesë përbërëse anësore e çështjes, e që te pjesa është e kundërta. Nëse Ligjvënësi i tërheq dy rekate të adhurimit katër rekatësh. Kjo do të nënkuptonte shfuqizimin e tërësishëm të atij adhurimi dhe pjesa tjetër do të mbetej adhurim tjetër në vete.⁵⁶

Argumentet

Shumica absolute e dijetarëve argumentohen me atë se, pakësimi i një pjese apo heqja e një kushti nuk e tërheq atë adhurim nga ligji obligativ apo ligji edukativ apo ligj tjetër, pra nuk është shfuqizim i saj. Siç dihet, shfuqizimi është tërheqja e ligjit shëriativ.

Argument se ai nuk e tërheq ligjin e atij adhurimi është se nuk ekziston argument i cili e dëshmon atë, për këtë arsye ka mbetur argumenti i cili e ka ligjësuar për të parën herë.

Hanefijtë argumentohen me atë se pakësimi i një pjese, apo heqja e një kushti të adhurimit e tërheq edhe ndalimin e gjithë atij veprimi edhe pa atë pjesë edhe pa atë kusht, dhe e bën veprën të lejuar pa ato. Ndalesa është ligj i shëriatit dhe tërheqja është shfuqizim.

Replikë – obligueshmëria e atij adhurimi pas pakësimit të asaj pjese, apo heqjen e atij kushti, është po i njëjti obligim para pakësimit apo heqjes së atij kushti, kështu mbetet ligji i ligjësimi të adhurimit, e ai ligj është obligimi dhe nuk është tërhequr ligji. Përderisa, sa i përket ndalimit të veprimit pa atë pjesë apo pa atë kusht, nuk ligjësohet për atë moment, por për të ardhmen, ndërsa tërheqja e ligjit bëhet prej atij momenti dhe jo për të ardhmen, dhe kjo rezulton në tërheqjen e ndalesës dhe nuk është shfuqizim.

Ata të cilët bëjnë dallimin (Gazaliu dhe të tjerët me të) argumentohen me atë se, pakësimi i pjesës në ligj është tërheqja e ligjit e cila është obligueshmëria e tërësisë sepse obligueshmëria e tërësisë hiqet me tërheqjen e një pjese të saj ashtu sikurse tërhiqen të gjitha pjesët dhe në bazë të kësaj, heqja e një pjese është shfuqizim i obligueshmërisë së adhurimit në tërësi, dhe pjesa tjetër mbetet adhurim tjetër në vete, e që e kundërta është heqja e kushtit, sepse nuk e ka tërheq ligjin tjetër përpos ligjin e tërhequr prej tij (kushtit) kështu që nuk është shfuqizim i ligjit tjetër përpos ligjit të tij.

Replikë – në fakt, pakësimi i pjesës, ka për qëllim tërheqjen e obligueshmërisë, përderisa sa i përket tërheqjes së obligueshmërisë së tërësishme dhe është çështje bashkëngjitëse dhe nuk shikohet në të.

Mendimi përfundimtar favorizues – Pakësimi i pjesës së ligjësuar apo heqja e një kushti prej kushteve, nuk është shfuqizim i bazës së saj por është shfuqizim i kësaj pjese ose i vetëm atij kushti.

E gjashta: Shfuqizimi i të kuptuarit konkret dhe i të kuptuarit të kundërt

Tregueshmëria e shprehjes për ligjin shariatik ose mund të jetë konkrete dhe quhet tregueshmëri e fjalës ose që tregohet përmes kuptimit i cili quhet tregueshmëria e të kuptuarit.

E kuptuara e heshtur ose që ligji është në përputhshmëri me ligjin shprehës që te mutkeliminët quhet *e kuptuara përputhëse* ose *përputhshmëria e ligjërimit* ose *ligjërimi tërheqës*, e që Hanefijtë e quajnë *tregueshmëria e tekstit*, siç është fjala e Zotit të Lartmadhëruar:

فَلَا تَقُلْ هُمَا أَفٌّ

“Dhe mos u thuaj as *uf* atyre.” (El-Isra : 23)

Nëpërmjet shprehjes tregon se është ndaluar t’u thuhet “uf”, ndërsa në aspekt kuptimor tregon se ndalohet “rrahja e prindërve”.⁵⁷

Përderisa nëse ligji është në kundërshtim me ligjin shprehimorë quhet e kuptuara e kundërt ose argumenti i ligjërimit apo kuptimi i ligjërimit.

Pa kurrfarë dyshimi se tregueshmëria e tekstit mund të jetë ndryshe nga tregueshmëria e të kuptuarit, mirëpo këto janë të pandashme me njëra-tjetrën. A lejohet të shfuqizohet shprehimorja dhe të mbetet e kuptuara që do të thotë: Nëse shfuqizohet ndalimi i “uf-it” a shfuqizohet “rrahja” apo kjo nuk bën pjesë? A ndalohet rrahja nëse shfuqizohet ndalimi i “uf-it” apo jo? Dijetarët janë dakorduar në lejin e shfuqizimit të kuptimit konkret dhe të kuptuarit të kundërt të menjëhershëm së bashku. Lejohet të shfuqizohet “uf-i” në thënien e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe mos u thuaj as *uf* atyre.” (El-Isra : 23)** me ndalimin e rrahjes dhe çështjet tjera të llojit të ofendimit.

Kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket shfuqizimit të njëres dhe jo tjetrës në katër drejtime:

1. **Lejohet shfuqizimi i njëres dhe jo i tjetrës.** Shfuqizohet shprehimorja, mbetet e kuptuara dhe shfuqizohet e kuptuara mbetet shprehimorja, që do të thotë: Nëse shfuqizohet njëra nuk është patjetër të shfuqizohet tjetra. Këtë mendim e favorizon autori “Muslimu Thubut” Hanefijë sepse shumë herë ka ndodhë që e kuptuara është më e fuqishme, si f.v., “rrahja” është më e fuqishme se e “britmës”. Përderisa sa i përket të kundërtës (shfuqizimi i të kuptuarës dhe jo kuptimi konkret) lejohet që me

vendim të jenë të pandashme, por mund edhe të ndahen (nuk është e domosdoshme të jenë të pandashme).

Replikë – nëse janë të pandashme dhe shkëputja e bazës obligon shkëputjen e degës dhe nuk mund të paramendohet që pasi të hiqet baza (më e fuqishme) të mbetet dega (më e pafuqishme).

2. Nuk lejohet shfuqizimi i njërës pa u shfuqizuar tjetra, nuk shfuqizohet shprehimorja e të mbetet kuptimorja dhe as të shfuqizohet kuptimorja dhe të mbetet shprehimorja, por shfuqizimi i njërës obligon shfuqizimin e tjetrës. Këtë drejtim e përkrah Bejdaviju, dijetar Shafijë, sepse e kuptuara është pasuese, ndërsa shprehimorja është e pasuar, dhe tërheqja e të pasuarës do të thotë tërheqje edhe e pasueses sepse shfuqizimi i të kuptuarës patjetëron shfuqizimin e shprehimores sepse e kuptuara është e domosdoshme, ndërsa shprehimorja është e domosdoshme prej saj, ndërsa tërheqja e të domosdoshmes patjetëron edhe tërheqjen e pjesës së patjetërsueshme prej saj.

Replikë – tregueshmëria e fjalës e cila është kuptimorja, është pasuese e shprehimores dhe ligji i kuptimores nuk është e pasuar prej ligjit të shprehimores. Ne e kuptuam se ndalimi i rrahjes është pasuese nga kuptimi ynë prej ndalesës së të bërtiturës, jo nga shkaku se **“rrahja”** është haram, por nga shkaku se e **“bërtitura”** është haram. Ajo çka mund të shfuqizohet është shfuqizimi i ndalimit të së bërtiturës dhe jo tregueshmëria e tekstit për të sepse ajo vazhdon të jetë konstante, që do të thotë se, tregueshmëria e shprehjes mbetet konstante pas shfuqizimit të shprehjes. Kështu pra, e pasuara nuk është tërhequr ashtu që të bëhet e patjetërsueshme të tërhiqet pasuesja.

3. Shfuqizimi i të kuptuarës patjetëron shfuqizimin e shprehimores, përderisa shfuqizimi i shprehimores nuk patjetëron shfuqizimin e të kuptuarës. Këtë drejtim e favorizon Ibni Haxhibi Malikijë sepse e kuptuara është e pandashme dhe tërheqja e së pandashmes është tërheqje e së pandashmes prej saj sepse shprehimorja është e pandashme prej saj, përderisa e kuptuara e pandashme. Nuk mund të paramendohet që të lejohet rrahja e cila është më e rrezikshme dhe të mbetet ndalesa e të bërtiturës e cila është më e lehtë, mirëpo lejohet shfuqizimi i ndalimit të “bërtitjes” dhe të mbetet ndalimi i rrahjes.

Këtë mendim e favorizoj, që do të thotë se, lejohet të shfuqizohet shprehimorja e tekstit, ndërsa të mos shfuqizohet e kuptuara, ndërsa nuk lejohet e kundërta.

4. **Nëse e kuptuara harmonizuese bëhet e llojit të kijasit (ky është mendim i Shafiiut), atëherë shfuqizimi i bazës është shfuqizim edhe i saj dhe me tërheqjen e tij nuk nënkuptohet shfuqizimi i bazës,** sepse e kuptuara është degë, ndërsa shprehimorja është bazë. Nëse shfuqizohet ligji i bazës, me të tërhiqet edhe ligji i degës, mirëpo nëse shfuqizohet ligji i degës nuk do të thotë se patjetër duhet të hiqet ligji i bazës sepse tërheqja e çështjes mbështetëse nuk obligon që të tërhiqet e mbështetura.

Nëse bëhet e llojit të tekstit, që do të thotë, gjuhësisht tregueshmëri e shprehjes (ky është mendim i Hanefijve), nuk do të thotë se shfuqizimi i njëres shfuqizon tjetrën, por lejohet të shfuqizohet shprehimorja dhe të mbetet kuptimorja dhe shfuqizimi i të kuptuarës dhe të mbetet shprehimorja. Ky është mendimi i të parës sepse të dy argumentet ndryshojnë dhe tërheqja e njëres nuk do të thotë tërheqje e tjetrës.

E shtata: Shfuqizimi i lajmeve

Lejohet të shfuqizohet lajmi i cili përmban ligj ngarkues të shariatit sepse ajo përmban konceptin e urdhëresave dhe ndalesave, dhe kjo lejohet të shfuqizohet, si f.v., kur thuhet “u kam urdhëruar” ose “ua kam ndaluar” ose “ua kam bërë obligim”.

Te shumica absolute e dijetarëve, nuk ka shfuqizim në vet lajmet në ngarkesa të cilat i mohojnë ato, që do të thotë se nuk lejohet të shfuqizohen kuptimet e lajmeve dhe besimin në lajmëtarin e cila është e kundërt, e ku për të lajmëron i Sinqerti, i Urti, sepse do të ishte deklaram për lejimin e rrenës dhe të gabuarës për lajmëtarin sepse kjo do të na shpinte te intuita dhe injoranca, të cilën e pretendojnë jehudët në bazën e shfuqizimit. Është menduar se është i vërtetë ky lajm në këtë kohë, pastaj më vonë menduan se ajo ishte gënjeshtër. Si do që të jetë, duhet bërë dallimin dhe duhet sqaruar në temë atë çka është e ndërlidhur me lajmin, që të hiqen disa perioda brenda atij lajmi. Ky është lloj specifikimi dhe jo shfuqizim i tërësishëm.

Ajo çka e ndërlihdh me të janë tri çështje:⁵⁸

1. **Leximi:**

Si f.v., leximi, siç është ajeti:

إِنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Vërtet, Allahu është i ditur për çdo send.” (El-Enfalë : 75),

وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Allahu ka mundësi për çdo send.” (El-Bekare : 284).

Pastaj thënia: “Zejdi është besimtar.” Dijetarët pajtohen se lejohet shfuqizimi.

2. **Ngarkesa nëpërmjet lajmit.**

Nëse është prej çështjeve të cilat lejohet ndryshimi. Shembull: “Lajmëroje Zejdin se Umeri është i sigurt.” Nuk ka mospajtim se lejohet shfuqizimi sepse mundet që në një kohë të jetë e dobishme, ndërsa në një kohë tjetër e dëmshme.

Dhe ka çështje të cilat nuk mund të jetë ndryshe, p.sh., lajmi se Zoti i Lartmadhëruar ekziston dhe lajmi për krijimin e botës:

a. Nëse shfuqizimi ka të bëjë me lajmërimin për mosngarkesë të së kundërtës, si f.v., të thotë: “Mos lajmëro se Zoti ekziston.” Nuk ka mospajtime se lejohet shfuqizimi.

b. Nëse shfuqizimi ka të bëjë me lajmërimin për ngarkesë të së kundërtës, si f.v., “Lajmëroje Muhamedin se Allahu nuk ekziston.” Për këtë ka mospajtime.

Esharijtë (deklarojnë): Lejohet shfuqizimi i atij lajmi sepse mendja nuk ka rol në perceptimin e veprës së mirë dhe të keqe.

Muëtezilët dhe Hanefijtë: Nuk e lejojnë një gjë të tillë sepse është ngarkesë me lajme të rreme. Është e keqe nga Ligjvënësi dhe është absurde të ndodh një gjë e tillë, sepse mendja ka rol në perceptimin e veprave të këqija.

Unë e përkrahi mendimin e dytë. Kjo çështje është vetëm çështje presupozuese dhe mendimi i Esharijve është vetëm mendim i izoluar në vete.

3. Shfuqizimi i përmbajtjes së lajmit dhe rezultatit të tij.

a. Ose mund të jetë tregueshmëria e lajmit i cili nuk ndryshon, si f.v., ekzistenca e Zotit dhe krijimi i botës. Nuk ka mospajtime në atë se kjo nuk lejohet, në atë çka është e ndërlidhur në vet lajmin dhe përmbajtjen e tij.

b. Nëse është çështje e cila ndryshon, si f.v., besimi dhe mosbesimi i Zejdut. Për këtë janë paraqitur tri mendime:

Mendim i parë: Absolutisht nuk lejohet, as për të kaluarën dhe as për të ardhmen, premtim apo kërcënim apo ligj shariatik. Të këtij mendimi janë: El Xhebaniju, Ebi Hashimi, Bakilaniu dhe një pjesë e mutekeliminëve, sepse shfuqizimi i lajmit do të pasqyroste gënjeshtren. Ndërsa që Ligjvënësi të gënjejë është absurditet. Ajo çka tregon se shfuqizimi i këtij lloji të lajmit është absurde, sepse po të thoshte Ligjvënësi “Prostitutit nuk ia fali kurrë.” dhe pastaj të thotë “Kam pasur për qëllim, për një vit.” Atëherë nuk iu është përmbajtur lajmit të parë dhe kjo llogaritet gënjeshtër.

Replikë – shfuqizimi i urdhërorit është e lejuar edhe pse paramendohet intuita (iluzioni). Është normale që Zoti i Lartmadhëruar ta parasheh që prostituti të dënohet me dënim të përgjithmonshëm e që më pastaj ta parasheh që të dënohet vetëm me një vit , e kjo nuk do të konsiderohej gënjeshtër.

Mendimi i dytë: Lejohet absolutisht shfuqizimi. Të këtij mendimi janë: Basrijinët (Ebi Husejni dhe Ebi Abdullahi), e përkrahë Amediju, sepse shfuqizimi përmban lajmin i cili nuk rezulton se mund të ndodhë e pamundura, për këtë arsye lejohet dhe zakonisht është argumentim i cili tregon fuqizimin.

Replikë – rezulton të pamundurën, nuk mund të paramendohet se është gënjeshtër, dhe është absurditet në vete, mirëpo fakti se qëllimi është shfuqizimi, që do të thotë nxjerrja e një pjese të cilën e përfshinë fjala dhe kjo është e lejuar.

Mendimi i tretë: Bëhet dallimi, nëse lajmi ka të bëjë për të kaluarën, nuk lejohet shfuqizimi. Këtë mendim e përkrahë Bejdaviu, dijetar Shafii, sepse lajmi i së kaluarës mund ta realizoj përmbajtjen dhe tërheqja do të thotë gënjeshtër për të, dhe kjo është e pavlefshme.

Përderisa, sa i përket lajmit që ka të bëjë për të ardhmen, nuk ka kurrfarë pengese që Ligjvënësi të thotë: **“Do ta ndëshkoj prostitutin përgjithmonë.”** dhe pastaj të thotë: “Kam dashur të them një vit.” dhe atëherë fjala e dytë është specifikim i të parës, për një periudhë kohore. Në këtë nuk ka absurditet, andaj edhe lejohet.

Sipas mendimit tim, prioritet ka mendimi ku as që mund të paramendohet mundësia e shfuqizimit të lajmeve për Allahun e Lartmadhëruar sepse rezulton se ai lajm është gënjeshtër ose harresë, dhe që të dyja janë absurde për Allahun dhe atë pa marrë parasysh a ka të bëjë me lajmin, i cili logjikisht nuk ndryshon siç është rasti për krijimin e botës, ose që ka të bëjë me lajmin i cili logjikisht ndryshon, dhe pa marrë parasysh a është lajm i së kaluarës, apo i së ardhmes sepse shfuqizimi do të nënkuptonte rrenën apo harresën dhe kjo nëse është për premtim sepse shfuqizimi është e kundërta e saj, ndërsa është e pamundur që Allahu të thyej premtimin.

Përderisa, sa i përket kërcënimit, lejohet shfuqizimi, dhe nuk konsiderohet mosmbajtje e premtimit, por është falje dhe fisnikëri dhe heqja dorë nga kërcënim i është çështje bamirësie dhe lavdërohet nga të gjithë njerëzit.

Sa i përket mendimeve të cilat i përmenda, siç sqaruam, janë specifikim dhe nuk janë shfuqizim.

E teta: Shfuqizimi i veprës dhe i fjalës në sunetin e pejgamberit.

Shafiiju dhe ai i cili e pason, e ai është Ibn Akijli Hanbelij deklarojnë se, shfuqizohet diçka që për nga kategoria është e njëjtë ose më e fuqishme. Fjala është më e fuqishme se veprimi, andaj fjalën e shfuqizon vetëm fjala dhe veprimin e shfuqizon vetëm veprimi.

Replikë – që të dyja llogariten sunet dhe janë të ligjësuara, për këtë janë dakorduar dijetarët dhe nuk ka pengesë që njëra të shfuqizon tjetrën, posaçërisht kur dihet se kjo në sunet ka ndodhur shumë herë, siç do të tregoj më vonë. Shafiiju nuk ka argument as logjik dhe as sheriatik për të argumentuar mendimin e tij.

Shumica absolute e dijetarëve deklarojnë se, vepra e ligjësuar në sunet, shfuqizohet me fjalën dhe fjala shfuqizohet me vepër.⁵⁹

Argumentet e tyre

a. Për vjedhësin, Muhamedi a.s. thotë: **“Dhe nëse e përsëritë për të pestën herë, ekzekutojeni, pastaj është tërhequr nga vjedhja për të pestën herë, dhe nuk e ka ekzekutuar. Ky mosveprim është shfuqizim i sunetit.”**

b. Në hadithin e Ibadetu bin Samed, peygamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Të martuarin dhe të martuarën, shkopimi njëqind herë, pastaj gurëzimi.”**,⁶⁰ pastaj e ka gurëzuar Maizin dhe nuk e ka shkopuar. Ky veprim është shfuqizim i shkopimit të atij i cili dënohet me gurëzim.

c. Në sahihë është vërtetuar se, peygamberi s.a.v.s. ka falur namaze të xhenazës, pastaj nuk e ka vepruar dhe kjo është shfuqizim.

d. Është vërtetuar të ketë thënë peygamberi s.a.v.s.: **“Faluni siç më shihni duke u falur.”**,⁶¹ pastaj ndonjëherë nuk e ka vepruar atë që e ka vepruar më herët. E edhe ky është shfuqizim. Raste të tilla në sunet ka shumë.

E nënta: Shfuqizimi i ligjit bazë me të cilin është analoguar çështja, nënkupton shfuqizimin degë të çështjes së analoguar

Disa Hanefijë thonë: Nuk është e patjetërsueshme që me shfuqizimin e ligjit bazë automatikisht të shfuqizohet edhe ligji i dytë, por lejohet që të mbetet ligji i degës pasi që të shfuqizohet ligji i bazës, sepse argumenti i ligjit të degës është ndryshe nga argumenti i ligjit të bazës, kështu edhe ligjet ndryshojnë, gjithashtu shfuqizimi i njërit ligj prej dy ligjeve të ndryshme nuk e bën që patjetër të shfuqizohet ligji tjetër.

Replikë – dy argumentet janë të ndryshme, mirëpo argumenti i ligjit të degës mbështetet në ligjin e bazës dhe tërheqja e bazës shkakton tërheqjen e degës.

Shumica absolute e dijetarëve të usulit, e po ashtu i përkrah edhe autori i librit “Muslimu thubut” i cili është Hanefijë, deklarojnë se: “Nëse shfuqizohet ligji bazë i kijasit, nuk mbetet ligji i degës, sepse shfuqizohet së bashku me të, sepse ligji i degës ligjësohet me arsyetimin e ligjit të bazës dhe kur të shfuqizohet baza, zhvlerësohet arsyeja, zhvlerësohet ligji i ligjësuar prej saj, që do të thotë, shfuqizimi i ligjit bazë e bën të pavlefshëm

edhe arsyen e atij ligji, ndërsa zhvlerësimi i tij shpie te zhvlerësimi apo te tërheqja ligjit të degës, i cili është ligjësuar duke u bazuar në të dhe nëse nuk tërhiqet, ai ligj mbetet pa argument.⁶²

Shembull: Është vërtetuar me hadithë se, kontakti intim gjatë ditës së agjërimit obligon kompensimin. Nëse arsyeja është penalizimi i ndalesës së agjërimit dhe i bashkëngjitet ushqyerja me qëllim gjatë ditës me kontaktimin seksual, pasi që arsyeshmëria është e njëjtë, atëherë shfuqizimi i obligimit të kompensimit për shkak të kontaktimit të tërhiqet obligueshmëria e kompensimit për shkak të ushqimit si mbështetëse e saj, sepse arsyeshmëria është: penalizimi, e cila është zhvlerësuar në rastin e tërheqjes së ligjit bazë, në të cilën ka qenë e bazuar.

Nëse thuhet: Mos i jep Zejdit, sepse ai është alkoolist, dhe pastaj me të analogohet Amri sepse edhe ai është alkoolist. Pastaj kjo dispozitë shfuqizohet nga Zejdi, atëherë automatikisht shfuqizohet edhe nga Amri, si mbështetje e asaj dispozite.

Tema e gjashtë: Rugët e të kuptuarit të shfuqizimit

Nëse në ligj gjenden dy tekste kundërthënëse, ligjësohet se njëra prej tyre, e cila është e mëvonshme është shfuqizues, dhe më e hershme e shfuqizuar, sepse në shariatë nuk ka kundërthënie. Nuk mund të dihet shfuqizuesi dhe e shfuqizuara deri kur të mësohet cila prej tyre ka zbritur e para dhe jo në bazë të radhitjes (sepse radhitja nuk është bërë në bazë të zbritjes) dhe të radhitjes kronologjike. Kjo njohuri nuk mund të arrihet përpos prej transmetimit, prej teksteve ose prej ixhmait, ose prej mendimit të transmetuesit dhe të ngjashme, të cilat do t'i sqarojmë.

Për të njohur rrugët e shfuqizimit, dijetarët e usulit i kanë përmendur gjashtë rrugë, e ato janë:⁶³

1. Shprehja e qartë në tekst të Kur'anit e cila e tregon shfuqizimin, si f.v., thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

الْآن خَفَّفَ اللَّهُ عَنْكُمْ

“Dhe tani, Allahu ua ka lehtësuar juve.” (El-Enfal : 66)

Kjo nënkupton shfuqizimin e një përballë dhjetëve.

Shembull tjetër: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“A u frikësuat (varfërisë) të jepni lëmoshë në prag të bisedës suaj? E kur ju nuk e bëtë dhe All-llahu ju fali, atëherë pra, faleni namazin, jepeni zekatin, respektojeni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, All-llahu është i njohur me punën tuaj.” (El-Muxhadele : 13)

është shfuqizues i urdhrit për dhënie sadaka para takimit me Muhamedin a.s.

2. Kur peygamberi shpreh qartë shfuqizimin, si f.v., kur thotë, kjo shfuqizohet prej kësaj, ose në kuptim të shfuqizimit, si f.v., **ua kam pas ndaluar vizitën e varreve, ndërsa tani vizitoni**. Kjo tregon se urdhri për vizitë të varreve është më i vonshëm se ndalesa. Kështu, urdhri është shfuqizues i ndalesës së mëparshme.

3. Veprimi i Muhamedit a.s., si f.v., gurëzimin e Maizit dhe mosshkopimi i tij. Ky veprim është shfuqizues i thënies: **“Të martuarin dhe të martuarën shkopojeni dhe gurëzojeni.”** Ai i cili e mohon që vepra të shfuqizon fjalën, thotë: Shfuqizues është thënia tjetër, ndërsa veprimi është sqarim i saj.

4. Ixhmai i sehabëve se kjo çështje është shfuqizuar dhe kjo është shfuqizues, si f.v., shfuqizimi i agjërimit të ditës ashura me agjërimin e muajit ramazan dhe shfuqizimi i të drejtave materiale me obligimin e zekatit.

5. Transmetimi i transmetuesit se sehabët kanë thënë se ky ligj është më i vonshëm se tjetri, kur nuk ka të bëjë me ixhtihadin, si f.v., ky ajet ka zbritur kështu pas këtij ajeti. Hadithi i filanit prej betejës së Bedrit, ndërsa hadithi i filanit prej betejës së Uhudit, ose thotë: E fundit që e ka thënë peygamberi s.a.v.s. është kjo, si f.v., thënia e Xhabirit r.a.: “Çështja e fundit të cilën e ka vepruar peygamberi s.a.v.s. është: e ka vazhduar faljen me abdesin edhe pse me atë abdes ka ngrënë mishin e përgatitur prej zjarrit.”⁶⁴ Kjo tregon se urdhri për abdes nëse ha ushqim zjarri është para urdhrit për të mos marrë abdes. Kështu, e fundit e shfuqizon të mëparshmen.

6. Natyrshmëria e ligjësisimit të dy ligjeve, ku njëra është në përputhje me traditën e mëhershme dhe e dyta, ligji sheriatik e shfuqizon atë zakonor.

Përfundim – Rruga për të njohur ligjin e shfuqizuar ka dy çështje:

- shprehja e shfuqizimit dhe e dyta,
- kronologjia kur të ndodh kundërthënia.

Çka nuk konsiderohen rrugë të shfuqizimit:⁶⁵

1. **Te Shafijjtë nuk realizohet shfuqizimi me thënien e sehabiut:** ka qenë ky ligj kështu e pastaj është shfuqizuar, sepse ekziston mundësia që ai e ka thënë në bazë të ixhtihadit të tij dhe jo nga teksti.

Hanefijtë e kundërshtojnë këtë qasje dhe e llogaritin prej argumenteve të shfuqizimit, sepse sehabiu konsiderohet i drejtë dhe fjala e tij na bën të ndjejmë se është qëndrim të cilin e ka dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s. dhe pranohet.

Hudariu e pranon mendimin e parë.

2. Që njëri prej ligjeve të jetë i ligjësuar sipas ndodhive në bazë të mus'hafit sepse suret dhe ajetet nuk janë të radhitura në bazë të kronologjisë së zbritjes së ajeteve dhe sureve.

3. Që transmetuesi e shpreh prej ngjarjeve të sehabeve. Sehabiju para islamit dhe islamit të mëvonshëm nuk është argument i shfuqizimit, sepse është e mundur që fëmija transmeton prej atij i cili është më i hershëm në shoqëri me të, ose mundet që të mëdhenjtë transmetojnë nga të vegjlit dhe e kundërta.

4. Që transmetuesi ta ketë pranuar islamin vonë, në kohën e çlirimit të Mekës, dhe nuk thotë se e ka dëgjuar në ditën e çlirimit, sepse është e mundur se e ka dëgjuar para pranimit të islamit, pastaj e transmeton pas islamit, apo e ka dëgjuar prej atij i cili e ka pranuar islamin para tij.

5. Hershmëria apo mëvonësia e sehabëve nuk është argument se teksti është i mëhershëm apo i mëvonshëm. Nëse transmetuesi i njërit prej teksteve e ka ndërprerë shoqërimin, është e mundur që të mendohet se hadithi i tij është para hadithit kur është shoqëruar me të. Nuk është e domosdoshme që të jetë shoqëruar më vonë, ashtu që hadithi të jetë i mëvonshëm nga momenti kur i ka shkëputur marrëdhëniet shoqërore.

6. Që njëri prej teksteve të jetë në përputhshmëri me atë që natyrshmëria bazë e pranon një gjë të tillë dhe nuk nënkupton se ai është para tjetrit sepse është e mundur se është e lejuar e pastaj është shfuqizuar.

Tema e shtatë: Koha dhe kronologjia e shfuqizimit

Shfuqizimi ndodhë vetëm në kohën e pejgamberit s.a.v.s., sepse shfuqizimi ndodhë vetëm nëpërmjet rrugës ligjore dhe ligji njihet vetëm me shpallje. Shpallja është vetëm në kohën e jetës së pejgamberit s.a.v.s., ndërsa pas vdekjes së tij nuk mund të shfuqizohet asnjë ligj sepse më vonë nuk ka shpallje dhe ligjësime.⁶⁶

Nga kjo krijohet baza se të gjitha ligjet të cilat janë vepruar në kohën e pejgamberit s.a.v.s. dhe nuk janë shfuqizuar, janë ligje strikte dhe të përgjithmonshme edhe pas vdekjes së tij, dhe nuk mund të shfuqizohen dhe as të ndryshohen. Këtë e tregon ajeti kur'anor:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ
الْإِسْلَامَ دِينًا

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe.”

Muslimani duhet t'i zbatoj ato ligje ashtu siç janë ligjësuar, sepse pejgamberi s.a.v.s. është vula e pejgamberëve, dhe pas tij nuk ka më pejgamber, e për këtë është argument thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo send.” (El-Ahzab : 40)

Sheriati islam është vula e sherieve qiellore dhe nuk ka mundësi të shfuqizohet apo ndryshohet, dhe sheriati mbetet zëri i vërtetë i Zotit për të gjitha ligjet deri në ditën e Kijametit:

قُلْ أَيُّ شَيْءٍ أَكْبَرُ شَهَادَةً ۖ قُلِ اللَّهُ ۖ شَهِيدٌ بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۚ
وَأُوحِيَ إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرْكُمْ بِهِ وَمَنْ بَلَغَ

“Thuaj: Cili send ka dëshminë më të madhe? Thuaj: All-llahu është dëshmues mes meje e jush, e mua më është shpallur ky Kur’an që me të t’ju tërheqë vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kijametit).!” (El-En’am : 19)

Shfuqizimi nuk hynë në fuqi pa iu kumtuar umetit

Dijetarët e usulit janë dakorduar se ligji i shfuqizuar nuk hyn në fuqi pa ia transmetuar Xhibrili a.s. pejgamberit s.a.v.s.

Po ashtu, ligji i kumtuar te pejgamberi s.a.v.s. nuk hyn në fuqi deri sa t’i kumtohet umetit të tij.

I ngarkuari, deri atëherë vepron me ligjin e vjetër deri sa të kumtohet ligji shfuqizues. Kjo është logjike, dhe ky është drejtimi i shumicës absolute të dijetarëve (Hanefijë, Malikijë dhe Hanbelijë) sepse po të hynte në fuqi para kumtimit, atëherë një çështje në të njëjtën kohë do të ishte edhe obligative edhe e ndaluar, sepse p.sh., ligji shfuqizues do të ishte ndalesë e të vepruarit të ligjit të parë, do të ishte haram për momentin, ndërsa në të kaluarën ka qenë obligim. Nëse nuk vepron me ligjin e shfuqizuar dhe ai nuk bindet se është shfuqizuar, ai automatikisht është mëkatar, ndërsa nëse atij i vërtetohet se është shfuqizuar dhe ai vepron, ai nuk bën mëkat.

Këtë mendime ka përzgjedhur Amediu, dijetar Shafijë.

Shafijët deklarojnë: Fuqizohet ligji para kumtimit. Në fakt, nuk ka mospajtim mes tyre dhe shumicës absolute, sepse ata kanë për qëllim ligjësimin e ligjit në vetvete, dhe jo për deri te i ngarkuari, sepse, si mund të ngarkohet njeriu pa iu kumtuar ngarkesa, dhe nuk ka mënyrë për ta kuptuar. Ky lloj ngarkese është absurditetit në vete.⁶⁷

Fusnotat:

1. “El-ihkam”, 2/160, Amediju.
“El-muëtemid”, 1/394, Ebil Husejn el-Basriu.
“Et-telvijh alet-tevdijh”, 2/31.
“Irshadul fuhulë”, 161.
“Muhtesar ibnul haxhib”, 160.
2. “Keshful esrarë”, 3/875.
“Et-telvijh alet tevdijh”.
“Usulus-sarhasij”.
“Muslimu thubutë”.
“El-mustesfa”.
“El-ihkam”.
“Xhem’ul xhevamiu ve sherhihi”.
“Sherhul Esnevij”.
“El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
“Irshadul fuhulë”.
“Muhtesar ibnul haxhib”, 160.
3. Shumica e hanefijëve, zhbërjen e ligjit të lejuar e llogaritin shfuqizim sepse njerëzit gjithmonë kanë gjetur zbatim ose deklarimi i lejimit legjislativ dhe tërheqja e tij është tërheqje e ligjit sheriativ.
4. “El mustesfa”.
“El ihkam”, 2/163, el Amedij.
5. “En-nasihu vel mensuhë”, autor Ibni Huzejme dhe “En-nasihu vel mensuhë fil Kur’anil Kerim”, autor Ibn Xheafer en-Nuhasi, 264.
6. “Err-Rrisalete”, 101, Shatibiu.
“El-med-hal ila medhhebil Ahmed bin Hanbel”, 97.
“Muslimu Thubutë”, 2/34.
“El-ihkam”, 2/967, el-Amedij.
7. “Usulul fikhi”, 180, prof. Ebu Zehra.
“Usulul fikhi”, 443-445, Bedran.
8. E ka transmetuar Ibni Maxhe nga Ibni Mes’udi. Është hadithë i saktë. E ka transmetuar el-Hakimi nga Enesi në formën e tekstit “pra vizitoni”.
9. “El-ensab”.
10. Transmeton Tirmidhiu nga Beridete. Hadithi është i saktë.
11. Transmeton Muslimi nga Beridete. Hadithi është i saktë.
12. “El-ihkam”, 3/164, el-Amediu.
“El-mustesfa”, 1/70.
“El-muëtemed”, 398, Ebil Husejn el Basriu.
“Muslimu Thubutë”, 2/35.
“Irshadul fuhulë”, 163.
“El-ihkam”, 4/446, Ibni Hazmi.
13. “Keshful esrarë”, 2/876.

14. “El-mustesfa”, 1/71.

“El-ihkam”, 1/165, el-Amedij.

15. “Et-Telvijh alet-tevdijh”, 2/33.

Qëllimi me termin lajm është për lajmet e çështjeve të kaluara ose të kohës së tashme ose të kohës së ardhshme, shfuqizimi i së cilës do të na shpinte në përgënjeshttrim apo injorancë, e që e kundërta është me lajmet për ndalesën apo lejimin e çështjeve si f.v. kjo është e ndaluar, kjo është e lejuar. Shafijët në këtë koncept e lejojnë shfuqizimin. (“Et-Telvijh”, 2/33; “El Ihkam”, 2/18, el Amedij.

16. “El-Ihkam li usulil Ahkam”, 4/444, Ibn Hazmi.

17. “Usulul Fikhi”, 450, prof. Bedran ebul inijn Bedranë.

18. “Keshful esrare”.

“Muslimu thubutë”.

“Et-Telvijh alet-Tevdijh”.

“Muhtesar Ibni Haxhib”.

“El-muëtemed”.

“El-Ihkam”.

“El-mustesfa”.

“Sherhul esnevij”.

“Irshadul fuhulë”.

19. Ibid.

20. Argumenti replikohet me ajetin sepse tregon domosdoshmërinë që kushti dhe pjesa të jenë të pandashme dhe nuk tregon se ka ndodhur kushti dhe pjesa (të ndara) dhe as lejimin se mund të ndodhin ashtu që ajeti të tregoj për lejimin e shfuqizimit sepse ka zbritur si kundërpërgjigje ndaj jehudëve të cilët e kritikonin pejgamberin s.a.v.s. për ndryshimin e drejtimit prej Mesxhidi Aksasë në Mesxhidi Haram.

21. “El-mustesfa”.

“El-ihkam”.

“Muslimu Thubutë”.

“Keshful esrarë”.

“Et-telvijh alet-Tevdijh”.

“Usulus sarhasij”.

“Xhemul xhevamiu” me “Sherhil mehalij”.

22. “El-ihkam”.

“Sherhul esnevij”.

“Muslimu thubutë”.

23. “Et-Telvijh alet-Tevdijh”.

“El-ihkam”.

“El-mustesfa”.

“Keshful Esrarë”.

“Usulus-Sarhasij”.

“El Ihkam”.

24. “Muslimu-th-thubutë”.

“Et-telvijh ale-t-tevdijh”.

“Keshful esrarë”.

“Usulus sarhasiji”.
 “El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
 “El-mustesfa”.
 “El-ihkam”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “El-muëtemed”.
 25. E ka regjistruar Ebu Davudi nga Enes bin Maliku r.a. (“Xhamiul usul”, 1/155).
 26. “El-mustesfa”.
 “El-med-hal ila medhheb Ahmed”.
 “Et-Tevdijh alet-tenkijh”, 2/32.
 “Muslimuth-Thubutë”.
 “Irshadul fuhulë”.
 27. “Et-Telviyh”, 1/33.
 “El-ihkam”, 2/180, el Amediju.
 “Irshadul Fuhulë”, 165.
 28. “Irshadul fuhulë”, 163.
 “El-med-hal ila medhhebil Ahmed”, 101.
 29. “Muslimu thubutë”.
 “Keshful esrarë”.
 “El mustesfa”.
 “El-ihkam”.
 “El-med-hal ila medhhebil Ahmed”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “Sherhul esneviy”.
 “Xhemul xhevamiu”.
 “El-muëtemed”.
 “Usulus-sarhasiji”.
 “El-ihkam”, 4/472, Ibn Hazmi.
 30. “Muslimu thubutë”.
 “El-Ihkam”.
 “Sherhul esneviy”.
 “El-muëtemed”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “El-med-hal ila medhhebil Ahmed”.
 “Err-Risaletu”, 109, imam Shafii.
 31. “El mustesfa”, 1/77.
 “El-ihkam”, 2/177, el Amediju.
 “El-ihkam”, 4/466, Ibni Hazmi.
 “Sherhul esneviy”.
 “El-muëtemed”.
 “Keshful esrarë”.
 “Muslimu Thubutë”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “Usulul Fikhi”.

32. Kjo në thënien e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe ata të cilët i mundon agjërimi (nuk mund të agjërojnë) le të ushqejnë një të varfër.” (El Bekare : 184), me thënien e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe kush prej juve prezanton në këtë muaj le të agjëroj.” (El Bekare : 185).

33. “El mustesfa”.

“El muhtesar”.

“El ihkam”.

“Sherhul Esnevi”.

“Usulus Sarhasiji”.

“Keshful Esrarë”.

“Et-Telviyh alet-Tevdijh”.

“El ihkam”, 4/477, ibn Hazmi.

“Irshadul fuhulë”.

“El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.

“Usulus-Sarhasiji”.

“El-muëtemed”.

34. E kanë transmetuar dymbëdhjetë sehabë dhe pesë tabiinë, e transmetojnë si hadithë mursel.

35. “El-ihkam”.

“El muhtesar”.

“Sherhul Esnevi”.

“Err-Rrisalete”.

Hadithin “në të katërtën herë alkoolistin ekzekutone” e ka transmetuar Ahmedi nga Ibni Amri. Hadithin shfuqizues e ka transmetuar Ebu Davudi, Tirmidhiu e ka përmendur vetëm si koncept. (“Nejlul Evtarë”, 7/146, 147).

36. “El ihkam”, 1/181, el Amediju.

“El ihkam”, 1/461, Ibni Hazmi.

“Sherhul esnevi”, 2/223.

37. Kundërpërgjigja në këtë bëhet me hadithin e Fatime bin Kajsit e cila ka thënë: Burri im më ka shkurorëzuar dhe pejgamberi s.a.v.s. nuk e ka paraparë që burri im të më furnizoj me ushqim apo të më siguroj vendbanim.

38. Kundërpërgjigja e hadithit të Muakal bin Sinan el Eshxhaijut bëhet me atë kur i ka thënë Ibn Mes’udit – ai veç gjykonte për gruan të cilës i kishte vdekur burri – se për të duhet të paguaj mehrin proporcional.

39. Transmetojnë një grup autorësh përpos Buhariut dhe Tirmidhiut nga Ibni Mes’udi. Ngjashëm është transmetuar nga Aliu dhe Halid bin Velidi.

40. “El-Ihkam”.

“El-mustesfa”.

“Irshadul fuhulë”.

“Muslimu thubutë”.

“Et-telviyh alet-Tevdijh”.

“Usulus-Sarhasiji2”.

“Keshful esrarë”.

“El-med-hal ila medhheb Ahmed”.

“Err-Risalet”, 108-113, Shafiiju.
 “El-ihkam”, 4/477, Ibni Hazmi.
 “El-muëtemed”.
 “Muhtesar Ibni Haxhibi”, 168.
 41. “Err-Risalet”.
 “Uslus-sarhasij”.
 “Muslimu Thubutë”.
 “Keshful esrarë”.
 “Et-Telvijh alet-Tevdijh”.
 “El-mustesfa”.
 “El-ihkam”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “El-med-hal ila medhhebi Ahmed”, 69.
 “El-muëtemed”, 1/424.
 “Muhtesar”, 169, Ibni Haxhibi.
 42. “Xhem’ul Xhevamiu”.
 “Sherhul xhelal mehalij”, 2/53, Es-Sebkij.
 43. “El-mustesfa”.
 “El ihkam”.
 “Muhtesar”.
 “Sherhul esnevij”.
 “Uslus-Sarhasij”.
 “Muslimu Thubutë”.
 “Et-Telvijh alet-Tevdijh”.
 “El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
 “El-ihkam”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “El-muëtemed”.
 44. “Uslul fikh”, 257.
 45. “Keshful esrarë”.
 “Muslimu thubutë”.
 “El-mustesfa”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “Uslul fikh”, 316, prof. Zekijud-dijn Shaëban.
 46. “El-mustesfa”.
 “El-Ihkam”.
 “Xhemul Xhevamiu”.
 “Keshful esrarë”.
 “El-med-hal ila medhheb Ahmed”.
 “Muslimu thubutë”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “El-Ihkam”.
 “Uslus Sarhasij”.
 “El-muëtemed”.

- “Muhtesar”, 170, Ibni Haxhib.
47. “El-ihkam fi usulil Ahkam”.
“El-mustesfa”.
48. Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Maliku në Muvetaë. Ibn Sen’ani thotë: Pjesa “dhe atyre u lexohej pjesë nga Kur’ani” ka kuptimin “ju kumtohej (lexohej) gjykimi dhe jo leximi i Kur’anit.
Bejhekiju thotë: Kuptimi i kësaj është: u lexohej atyre të cilëve nuk u është arritur zbritja e shfuqizimit.
49. “El mustesfa”.
“Usulus-Sarhasij”.
“Et-Telvijh alet-Tevdijh”.
“El-med-hal ila medhheb Ahmed”.
“Keshful esrarë”.
“Irshadul fuhulë”.
“Muhtesar”, 166, Ibni Haxhib.
50. Ibid.
51. “Usulul Fikh”, 257.
52. Transmeton Et-Taberaniju dhe Ebu Neimi në “El-Hilijeti”, Hakimi dhe Bejhekiju nga Ibni Abasi. Hadithi është i mirë.
53. “Keshful esrarë”.
“Usulus-Sarhasiju”.
“Et-Tevdijh”.
“Muslimu thubutë”.
“El-muëtemed”.
“Muhtesar”, 176, Ibni Haxhib.
“El-ihkam”.
“Sherhul esnevij”.
“El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
“Irshadul fuhulë”.
“Mudhkiretun fi usulil fikhi”, prof. Ebu Nur Zekijr, fq. 3/96.
54. “Usulul fikh”, 363, el-Hudarij.
55. Transmeton Ahmedi dhe katër autorët e suneneve dhe Hakimi nga Ibni Umeri. Hadithi është i saktë.
56. “Xhemul xhevamiu men sherbul mehalij”, 3/63.
“El-ihkam”.
“El mustesfa”.
“El-muëtemed”.
“Muhtesar Ibni Haxhib”.
“Sherhul Esnevij”.
“Irshadul fuhulë”.
57. “Xhem’ul xhevamiu”.
“Muslimu thubutë”.
“Muhtesar ibni Haxhib”.
“Sherhul Esnevij”.

“El muëtemed”.
 “El-ihkam”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “Mudhiredun fi usulil fikhi”, 3/90, prof. Zehijrë.
 58. “El muëtemed”.
 “Muhtesar Ibni Haxhib”.
 “Xhem’ul xhevamiu”.
 “El Ihkam”.
 “Irshadul fuhul”.
 “Muslimu thubutë”.
 “Usulus Sarhasij”.
 “Sherhul Esnevij”.
 “Mudhkiretu fi usuli fikh”, 3/69-73, prof Zehijrë.
 59. “Irshadul fuhulë”.
 “Xhem’ul xhevamiu bi sherhil mehalij”, 2/69.
 60. Transmeton Ebu Davudi nga Xhabir bin Abdullahu. Transmeton Jealij nga Muhamed bin Hatibi ose Harithi. (“Xhemul fevaïd”, 1/760; “Mexhmea zevaïd”, 6/277).
 61. Transmeton Ahmedî dhe Buhariu nga Malik bin Huvejrithi. (“Nejlul Evtarë”, 2/170).
 62. Transmeton Ebu Davudi nga Xhabir bin Abdullahi.
 Transmeton Ebu Jealij nga Muhamed bin Hatibi ose Harithi (“Xhemul fevaïd”, 1/760; “Mexhmea Zevaïd”, 6/277).
 63. “El-mustesfa”.
 “Sherhul esnevij”.
 “El-muëtemed”.
 “El-ihkam”.
 “El-med-hal ila medhheb Ahmed”.
 “Irshadul fuhulë”.
 “Usulul fikhi”, 264, el-Hudarij.
 64. Transmeton Ebu Davudi dhe Nesaiju nga Xhabiri. (“Nejlul Evtarë”, 1/209).
 65. “El-mustesfa”, el Amedij.
 66. “Keshful Esrarë”.
 “Usulul fikhi”, 319, prof. Zekijud-dijn Shaëban.
 67. “Et-Temhidë fi tehrixhil furuë alel usul”, 133.
 “El-Esnevij”.
 “El-ihkam”, 2/192.
 “Muhtesar Ibni Haxhibi”, 173.
 “Usulul fikhi”, 261, el-Hudarij.

Përmbajtja:

<i>Hyrje në shfuqizim</i>	4
Tema e parë	7
Kuptimi terminologjik	8
Pjesët përbërëse të shfuqizimit	10
Urtësia e shfuqizimit	11
Shembuj të ligjësisë, ku shihet fleksibiliteti i urtësisë së zbatimit të shfuqizimit	13
Dallimi në mes të shfuqizimit dhe intuitës	17
Dallimi në mes të shfuqizimit dhe specifikimit	20
Dallimi në mes të shfuqizimit dhe të pëcaktimit	22
Tema e dytë: Mendimet e dijetarëve për shfuqizimin	24
E para: Shfuqizimi te ithtarët e librit (jehudët dhe të krishterët)	24
E dyta: Shfuqizimi në islam	25
Argumentet e shumicës absolute të dijetarëve.....	26
Argumentet e ndodhjes së shfuqizimit	29
Argumentet e Ebu Muslim el Esfehanijut	31
Tema e tretë: Sfera e shfuqizimit dhe kushtet e saj	32
Sfera e shfuqizimit.....	32
Shfuqizimi para mundësisë së kryerjes së veprimit	36
Shfuqizimi i zëvendësimit.....	39
Lloji i zëvendësuesit në argumentin e shfuqizuesit	40
Tema e katërt: Llojet e shfuqizimit në argumentet e sheriatit	42
E para: Shfuqizimi i Kur'anit me Kur'an.....	43
Mendimi i Ebu Muslimit.....	46

E dyta: Shfuqizimi i sunetit me sunet.....	48
E treta: Shfuqizimi i sunetit me Kur'an	50
E katërta: Shfuqizimi i Kur'anit me sunet.....	52
E pesta: Shfuqizimi i argumenteve jotekstuale.....	55
Ixhmai nuk mund të jetë shfuqizues	56
Shfuqizimi i kijasit.....	58
Tema e pestë: Format e shfuqizimit dhe mënyrat e tij.....	60
E para: Shfuqizimi i ligjit dhe leximit së bashku	60
E dyta: Shfuqizimi i ligjit dhe i joleximit	61
E treta: Shfuqizimi i leximit dhe jo i ligjit.....	62
E katërta: Shfuqizimi nëpërmjet aneksit në tekst.....	63
E pesta: Paraqitja e mungesës në adhurim.....	67
E gjashta: Shfuqizimi i të kuptuarit konkret dhe i të kuptuarit të kundërt	69
E shtata: Shfuqizimi i lajmeve	71
E teta: Shfuqizimi i veprës dhe i fjalës në sunetin e pejgamberit. ..	74
E nënta: Shfuqizimi i ligjit bazë me të cilin është analoguar çështja, nënkupton shfuqizimin degë të çështjes së analoguar	75
Tema e gjashtë: Rrugët e të kuptuarit të shfuqizimit	76
Tema e shtatë: Koha dhe kronologjia e shfuqizimit.....	79
Shfuqizimi nuk hynë në fuqi pa iu kumtuar umetit	80

